



Humanitarian Law Center
Fondi për të Drejtën Humanitare
67 Rrustem Statovci Str, 11/2, Prishtina, Kosovo
Tel/fax: + 381 38 243488 / 490
E-mail: office@hlc-kosovo.org
Home Page: <http://www.hlc.org.yu>

Pakicat etnike në Kosovë në vitin 2005.

Fond za Humanitarno Pravo (FHP)
Nataša Kandić, Izvršni direktor
Adresa: 67 Makenzijeva, 11110 Beograd, Srbija i Crna Gora
Tel.: +381 11 3444 313
Fax: +381 11 3444 314
E-mail: natasakandic@hlc.org.yu Web:
Web: <http://www.hlc.org.yu>

Fondi për të Drejtën Humanitare
Fahredin Shehu, Koordinator Projekta za Kosovo
Adresa: 67 Rrustem Statovci STR, 11/2, Priština, Kosovo
Tel/fax: + 381 38 243488 / 490
E-mail: office@hlc-kosovo.org
<http://www.hlc.org.yu>

Përmbajtja:

Hyrje

1. Levizja e lirë

- 1.1 -----Komuna e Rahovecit
- 1.2 -----Komuna e Prizrenit
- 1.3 -----Komuna e Novo Bërdës
- 1.4 -----Komuna e Klinës
- 1.5 -----Komuna e Pejës

2. Kthimi i të zhvendosurve

- 2.1.-----Komuna e Lipjanit
- 2.2.-----Komuna e Klinës
- 2.3.-----Komuna e Pejës
- 2.3.1.-----Fshati Belopojë
- 2.3.2 -----Fshati Sigë e Brestovik
- 2.4.-----Komuna e Vushtrrisë
- 2.5.-----Komuna e Rahovecit
- 2.5.1.-----Fshati Zoçishtë
- 2.6.-----Komuna e Obiliqit
- 2.6.1.-----Kampi i i Plemetinit
- 2.7.-----Komuna e Mitrovicës
- 2.7.1.-----Mahalla e Romëve
- 2.8.-----Komuna e Prizrenit
- 2.8.1.-----Fshati Skenderaj i P.

3. Qasja e barabartë në institucione, shërbime publike, edukim, punësim dhe e drejta në përdorimin e barabartë të gjuhës amtare

- 3.1.-----Komuna e Lipjanit
- 3.1.1.-----Fshati Lubovc-Lipjan
- 3.2.-----Komuna e Gjilanit
- 3.2.1.-----Fshati Ponesh
- 3.3.-----Komuna e Rahovecit
- 3.3.1.-----Fshati Zoçishtë

4. Dhuna/incidentet e motivuara nga pikëpamja etnike-racore

- 4.1 -----Vrasja e avokatit Ibish Çakali nga Prizreni
- 4.2 -----Sulmi ndaj katër të rinjve serbë në rrugën Ferizaj– Shtërpce

- 4.3 -----Sulmi ndaj patrullës policore
- 4.4 -----Sulmi ndaj kolonelit të SHPK-së Dejan Jankoviqit
- 4.5 -----Sulmi ndaj çiftit bashkëshortor serb në fshatin Çerkolez, komuna e Istogut
- 4.6 -----Vrasja e Smajl Sukuricës, Boshnjak nga fshati Dobrushë, komuna e Istogut
- 4.7 -----Dy sulme ndaj ashkalinjve në Ferizaj
- 4.8 -----Të shtënat ndaj shtëpisë së një ashkaliu në fshatin allas, komuna e Lipjanit
- 4.9--Dy sulme me mjete shpërthyes ndaj shtëpisë së një shqiptari në pjesën veriore të Mitrovicës
- 4.10 -----Minimi i një shtëpie të serbit në fshatin Kllokot, komuna e Vitisë
- 4.11 -----Hudhja e bombave në shtëpinë e serbit të kthyer në Klinë
- 4.12 -----Të shtëna ndaj serbit në fshatin Sushicë afër Graçanicës

5. Gjykimet lidhur me ngjarjet e marsit në Kosovë

- 5.1-----Gjykimi lidhur me lëndën e „Sadri Shabanit dhe të tjerëve“
- 5.2 -----Gjykimi lidhur me lëndën e „Xhevdet Sulejmanit“
- 5.3 -----Gjykimi lidhur me lëndën e „Mehmet Morinës“
- 5.4 -----Gjykimi lidhur me lëndën e „Jeton Zogajt dhe të tjerëve“

Rezime

Hyrje

Fondi për të Drejtën Humanitare, në bazë të kërkimeve të kryera në terren, përcjelljes së mediave e gjykimeve të mbajtura lidhur me ngjarjet e marsit në Kosovë dhe informatave të tjera, konsideron se, përkundër përpjekjeve të autoriteteve, gjendja e bashkësive etnike në Kosovë nuk ka arritur standardet themelore të të drejtave të njeriut. Disa komuna, si p.sh. Klina/Klina, janë një shembull i mirë lidhur me kthimin e të zhvendosurve dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare.

Ky raport mbështetet në mbi 60 intervista me pjesëtarët e bashkësive etnike në lidhje me këto çështje: liria e levizjes, kthimi i të zhvendosurve, qasja e njejtë në institucione, qasja në shërbimet publike, arsim, edukim dhe punësim, e drejta në përdorimin e gjuhës amtare dhe rindërtimi i shtëpive, si dhe në intervistat me viktimat e incidenteve të motivuara etnikisht dhe në të dhënat që i disponojmë lidhur me dënimin e individëve për dhunën etnike të ushtruar më 17 mars 2004.

Sipas dokumentacionit të Fondit për të Drejtën Humanitare të drejtat janë shkelur ndaj serbëve dhe romëve, e më pak ndaj boshnjakëve, ashkalinjve, egjiptasëve dhe turqve.

Në disa mjedise serbët u janë ekspozuar formave të ndryshme të dhunës së intenzitetit më të dobët, por edhe presioneve nga Beogradi që në Kosovë shohin vetëm elemente ekstreme e kjo nuk paraqesin gjendjen e vërtetë. Kjo po e pengon integrimin e një numri më të madh të serbëve që të integrohen në realitetin e këtushëm dhe shton frikën nga levizja pa përcjellje e njëkohësisht ndikon në krijimin e një ambienti të pasigurtë. Problem të veçantë paraqet mosrespektimi i të drejtave pronësore. Edhe më tutje është i madh numri i shtëpive, banesave, i lokaleve dhe i tokës bujqësore të uzurpuar pronarë të të cilave janë pjesëtarët e bashkësive etnike, gjë që realisht paraqet një pengesë të madhe për kthimin e personave të zhvendosur. Të dhënat e FDH të siguruar nga biseda me serbët që e kanë braktisur Kosovën, tregojnë se atyre u kushtohet më pak kujdes se sa të kthyerve.

Në shumë mjedise në të cilat ishin shkatërruar banesat dhe shtëpitë, rindërtimi dhe renovimi i tyre nuk është bërë si duhet, ngase janë bërë lëshime të shumta. Në shumë raste objektet e reja kanë sipërfaqe më të vogël se ato të vjetrat, pastaj nuk janë të suvatuara, nuk e kanë të instaluar kanalizimin, ujësjellësin dhe rrejetin elektrik, ndërkaq mungojnë edhe objektet e tjera të infrastrukturës, kështu që në këto mjedise nuk ka të kthyer edhe pse shtëpitë e tyre janë rindërtuar, si p.sh. në fshatrat Bablak/Babljak, Magurë/Magura dhe /Pogorc/Podgorce.

Në kampin e Plemetinë/Plemetina kanë mbetur rreth 36 familje rome dhe ashkalinje dhe disa refugjatë nga Kroacia të cilëve këtu u është siguruar vendosja e domosdoshme. Këta njerëz jetojnë në kushte shumë të vështira dhe fare pak po bëhet që atyre t'u përmirësohen kushtet e jetesës.

Në lidhje me kthimin e një numri më të madh të njerëzve, personat e zhvendosur që vijnë kohë pas kohe në Kosovë për vizita të shkurtëra, si dhe ata që tani më janë kthyer, theksojnë se është i domosdoshëm implementimi më efikas i standardeve që sipas

mendimit të tyre nuk po zbatohen plotësisht. Po ashtu, ata shpresojnë shumë edhe në procesin e decentralizimit, që sipas tyre do të krijonte kushte për një siguri më të madhe, si dhe më tepër të drejta dhe kompetenca. Ata theksojnë se edhe më tutje është e domosdoshme prania e forcave ndërkombëtare në Kosovë. Mirëpo, serbët për dallim nga boshnjakët, goranët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe turqit, edhe më tutje janë jashtë institucioneve politike të Kosovës dhe i kanë institucionet paralele në sferën e arsimit dhe të shëndetësisë.

Situata ekonomike në Kosovë është e rëndë, gjë që objektivisht më së shumti e godet popullsinë shumicë, përkatësisht shqiptarët. Shkalla e papunësisë është shumë e lartë, kurse numri i të varfërve është shumë i madh. Nuk ka vende të reja të punës, është i pranishëm krimi i organizuar dhe korrupsioni. Vlen të theksohet se procesi i privatizimit krijon në punësim mundësi për diskriminim mbi baza etnike. Të gjitha këto edhe më tepër e vështirësojnë pozitën e pjesëtarëve të bashkësive etnike.

Fondi për të Drejtën Humanitare pos hulumtimit të rasteve konkrete të shkeljes së të drejtave të pakicave, pastaj të gjendjes së të drejtave të bashkësive etnike dhe në mënyra të tjera, siç janë vizitat në zyrat komunale të bashkësive, po ashtu merr pjesë në mbledhjet e grupeve të punës për kthim, bisedon me përfaqësuesit e organeve lokale të pushtetit, me përfaqësuesit e komisioneve për vlerësimin e dëmeve dhe rikonstruktimin e objekteve të dëmtuara gjatë trazirave të 17 e 18 marsit të vitit 2004 dhe me përfaqësuesit e organizatave humanitare ndërkombëtare që punojnë në implementimin e projekteve për kthimin e personave të zhvendosur, veçmas me të kthyerit nga radhët e të gjitha bashkësive etnike.

Kërkimet lidhur me ndërtimin ose rindërtimin e shtëpive të reja, FDH i kryer në këto vende dhe komuna: Klinë/Klina (qytet), Gjilan/Gnjilane (qytet) dhe fshati Ponesh/Poneš, Novobërd/Novo Brdo (komunë), fshati Klokubar/Klobukare, Viti/Vitina (qytet) dhe fshati Zhiti/Šitinje, Fushë Kosovë/Kosovo Polje (komunë), Obiliq/Obilić (komunë), Pejë/Peć (komunë) dhe fshati Sigë/Siga dhe Bellopojë/Belo Polje, Prishtinë/Priština (komunë) dhe fshati Qagllavicë/Čaglavica, Gjakovë/Đakovica (qytet), Vushtrri/Vučitrn (qytet), Ferizaj/Uroševac– qytet, Prizren/Prizren (qytet).

Me qëllim të mbledhjes së shënimeve lidhur me shkeljen e të drejtave të pakicave kërkimet janë kryer në këto vende: Prizren/ Prizrenu, Dragash/Dragašu, Vranishtë/Vraništu, Fezizaj/Uroševcu, Bablak/Babljaku, Shtime/Štimlju, Lipjan/Lipljanu, Mitrovicë/Kosovskoj Mitrovici, Viti/Vitini, Krushë e Madhe e Krushë e Vogël/Velikoj i Maloj Kruši, Celinë/Celina, Bellacërkë/Beloj Crkvi, Pastales/Pustom Selu, Prishtinë/Prištini, Reçak/Račku, Magurë/Maguri, Dejë/Danjanu, Rahovec/Orahovcu, Hoçë e Madhe/Velikoj Hoçi, Zoqishtë/Zočistu, Doganaj/Doganovcima, Grackë/Starom Gradskom, Landovicë/Landovici, Pogorc/Podgorcu, Letnicë/Letnici, Shasharë/Šašaru, Vranakollë/Vrnakovolu, Vrnez/Vrenezu, Kllokot/Klokotu, Gjilan/Gnjilane, Sreckë/Sredskoj, Ponesh/Ponešu, Zhiti/Žitinju, Planjanë/Planjanu, Smirë/Smiri, Vërboc/Vrbovcu, Gjylekar/Đelekaru, Lupishtë/Lupištu, lagja „2 korriku“ në Prizren/Prizrenu, Shtërpc/Štrpcu, Gllloboçicë/Globoçici, Novobërd/Novom Brdu,

Bostan/Bostanu, Balanc/Balancu, Tërničevc/Trničevcu, kampi Plemetinë/Plemetina, Janjevë/Janjevu, Sërbicë e Ulët/Donjoj Srbici, Robovc/Rubovcu, në manastirin Deçan/Deçani dhe në disa vende të tjera.

1. Levizja e lirë

Në komunat në të cilat FDH e ka përcjellë realizimin e të drejtës në lirinë e levizjes ekzistojnë zyrat që merren me kthimin e pjesëtarëve të pakicave që po ashtu angazhohen edhe për zgjidhjen e problemeve të bashkësive etnike që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për kthim, sigurinë personale dhe kthimin e pasurisë së uzurpuar.

1.1. KOMUNA E RAHOVECIT/ORAHOVCA

Në këtë komunë zyra për kthim dhe pakica është formuar më 1 prill 2005 dhe është vendosur në fshatin Hoçë e madhe/Velika Hoča. Zyrës i drejtohen pjesëtarët e pakicave që jetojnë në rajonin e kësaj komune. Më së shpeshti drejtohen lidhur me ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive, lirim të pasurisë së uzurpuar, zgjidhjen e të drejtave pronësore, marrjen e dokumenteve personale, për pension, ndihmë sociale etj.

Mbi 50 familje të zhvendosura kanë shprehur dëshirën që të kthehen në fshatin Zoqishtë/Zočište. Lidhur me mundësinë e kthimit kanë biseduar me fqinjët shqiptarë të cilët nuk kanë shprehur rezervë në lidhje me të drejtën dhe gatishmërinë e tyre që të kthehen. Duke pasur këtë parasysh Ministria për Kthim dhe Pakica e Qeverisë së Kosovës ka hartuar projektin për ndërtimin e 44 shtëpive për serbët dhe shqiptarët që do të ktheheshin, pastaj për ndërtimin e ambulancës dhe të tërë infrastrukturës së nevojshme. Për këtë qëllim Qeveria e Kosovës ka siguruar 1.800.000 euro. Nga kjo shumë UNDP-ja ka lejuar 400.000 euro për ndërtimin e shtëpive të serbëve në Rahovec/Orahovcu, për të kthyerit Predrag Matiqin dhe Sergej Stoliqin. Meqë ka edhe serbë të tjerë që janë të interesuar të kthehen, është planifikuar që në fazën e dytë të ndërtohen edhe 10 shtëpi.

Sa i përket lirisë së levizjes, shumica e serbëve ende nuk merr guximin të shkojë në pjesën e poshtme të qytetit, edhe pse gjithnjë e më shpesh ka të atillë që shkojnë në qytet.

FDH ka konstatuar se në komunën e Rahovecit/Orahovac nuk ka pasur incidente etnike dhe se disa serbë kanë filluar ta vizitojnë pjesën e poshtme të qytetit në të cilën jetojnë shqiptarët, kurse nga kjo pjesë e qytetit disa shqiptarë lirisht shkojnë në pjesën serbe të qytetit të Rahovecit/Orahovca. Ja çka deklaroi për FDH koordinatori i Zyrës për Kthim dhe Pakica të Rahovecit/Orahovcu Tatjana Kolashinac:

„Njerëzit kanë filluar më lirshëm të levizin dhe nuk janë shënuar incidente mbi baza etnike. Disa serbë shkojnë në pjesën e poshtme të Rahovecit/Orahovca, kurse shqiptarët në pjesën e epërme ku janë të vendosur serbët. Unë shpeshherë shkoj nga pjesa e epërme në pjesën e poshtme të Rahovecit/Orahovca. Rrugës takoj shqiptarë dhe ata më përshëndesin në gjuhën serbe,, 'dobro jutro', 'zdravo', kurse unë u përgjigjem në shqip 'mirëmëngjes', 'tungatjeta'. Me disa prej tyre ndalem dhe bisedoj dhe nuk ka kurrfarë problemesh. Mendoj se një sjellje e tillë është e mirë, ngase u jep kurajo serbëve të zhvendosur dhe të tjerëve që të kthehen në shtëpitë e tyre.“

1.2. KOMUNA E PRIZRENIT/PRIZREN

Në kazermën e KFOR-it në Prizren/Prizrenu, ku janë vendosur serbët pas ngjarjeve të 17 marsit të vitit 2004, edhe më tutje qëndrojnë rreth dhjetë serbë. Lepasava Pitoviq, Nadezhda Krupnikoviq dhe Draginja Petrovq janë duke pritur që tu rindërtohen shtëpitë në lagjën „Nënkalaja“ (Podkaljaja), që janë shkatërruar dhe djegur gjatë trazirave të 17 marsit të vitit 2004. Në kazermën e KFOR-it jeton edhe familja Nedeljković, Mladen, Divna dhe vajza e tyre Vera, e cila punon në Zyrën për Çështjet e Bashkësive në Prizren. Shtëpia e tyre në Prizren/Prizrenu është rindërtuar, por ata ende nuk janë kthyer. Edhe shtëpia e Natalija Kërstiqit po ashtu është rindërtuar, por ajo ende nuk ndihet e sigurtë që të kthehet. Në kazermën e KFOR-it jetojnë njerëz të moshuar dhe që nuk gëzojnë siguri sociale e të cilët para 17 marsit të vitit 2004 kanë banuar në Bogoslovinë „Qirillo dhe Metodie“ në Prizren/Prizrenu.

Sipas thënieve të serbëve me të cilët hulumtuesit e FDH kanë biseduar në kazermën e KFOR-it, gjendja e tyre është gjithnjë e më e rëndë. Ushtarët e kontigjentit gjerman të KFOR-it kanë aplikuar një regjim të ashpër, kështu që tani nuk ua lejojnë as shfrytëzimin e telefonit. U kanë suprimuar ndihmën shëndetësore, kështu që në rast nevojë serbët duhet të shkojnë në Shtërpce/Štrpce, që është larg Prizrenit/Prizrena 40 km. Po që se dëshirojnë të shkojnë në qytet ose ti vizitojnë shtëpitë e tyre apo për ndonjë punë tjetër, serbët këtë duhet ta bëjnë me përgjegjësi të vet. Që nga janari i vitit 2005 priftërinjtë ortodoksë nuk mund të hyjnë në këtë kazermë. Me rastin e festës së Zonjës së Madhe (muaji gusht), ka shërbyer prifti katolik në uniformën e KFOR-it, në kapelën në të cilën e kryen meshën për ushtarët besimtarë. Vlen të theksohet se pjesëtarët e KFOR-it i kanë dërguar serbët më 28 gusht në manastirin e Deçanit/Visoki Dečani për të marrë pjesë në solemnitetin e organizuar për nder të kësaj feste.

Se serbët po ndihen më të sigurtë në Prizren/Prizrenu flet edhe e fakti që e kanë konstatuar aktivistët e FDH se gjatë 4-5 muajve të fundit ata pothuajse çdo ditë dalin nga kazerma dhe lirisht shëtisin nepër qytet. Nganjëherë ata edhe me taksi shkojnë deri te shtëpitë e tyre për të parë se si po rrjedhin punimet përfundimtare dhe bisedojnë me

zhvilluesit e punimeve. Me atë rast takohen me shqiptarët, turqit dhe myslimanet me të cilët janë njohur edhe më parë dhe me ta lirshëm bisedojnë e me disa prej tyre edhe ulën të pijnë nga një pije. Po ashtu, lirisht shkojnë në shitore dhe në institucione publike për t'i kryer punët e tyre personale.

1.3. KOMUNA E NOVOBËRDËS/NOVO BRDO

Novobërda/Novo brdo është një komunë e vogël në pjesën lindore të Kosovës në të cilën qytetarët serbë, shqiptarë dhe romë kanë jetuar tradicionalisht në mardhënie të mira ndërnjerëzore. Në këtë komunë shumicën e popullësisë e përbëjnë serbët. Sipas shënimeve të UNHCR-it para konfliktit të armatosur në Kosovë më 1999 në strukturën e popullësisë së kësaj komune serbët kanë marrë pjesë me 2.680 veta, shqiptarët me 2.158 dhe romët me 86 veta.

Me gjithë faktin se pas ardhjes së forcave ndërkombëtare në Kosovë këtu nuk pati akte dhune sikur në mjediset e tjera të Kosovës, megjithatë numri i popullësisë serbe është zvogëluar në 1.117 veta. Ndërkohë, ky numër paksa është rritur me kthimin spontan dhe të organizuar të serbëve të zhvendosur. Komuna e Novobërdës/Novo Brdo është e para që ka hartuar strategjinë për kthimin e personave të zhvendosur.

Të gjithë qytetarët e komunës së Novobërdës/Novo Brdo, pa marrë parasysh se a janë serbë, shqiptarë apo romë, mund të levizin lirshëm dhe pa frikë të punojnë në pronat e tyre. Mund të konstatojmë se këto të drejta nuk i janë cenuar askujt. Po ashtu, askujt nuk i është uzurpuar pasuria, pos disa banesave në pronësi shoqërore në lagjen „Kolonija e Re“ (Nova Kolonija), ku shqiptarët i kanë uzurpuar banesat e serbëve. Këta shqiptarë janë të gatshëm t'i lirojnë ato por serbët nuk po shprehin gatishmërinë për t'u kthyer duke parashtruar disa kushte, pos tjerash edhe që t'u sigurohet punësimi. Në këtë komunë nuk ekziston asnjë objekt industrial apo ndonjë ndërmarrje e madhe ku ata do të mund të punësoheshin.

Që nga marsi i vitit 2004 nuk është shënuar as më i vogli incident në baza etnike.

1.4. KOMUNA E KLINËS/KLINA

Siç është e njohur, në komunën e Klinës/Klina në gjysmën e dytë të vitit 1999 nuk kishte mbetur asnjë pjesëtarë i bashkësisë serbe. Është dashur të kalojnë tre vjet që të fillojë procesi i kthimit. Së pari, serbët lokal u kthyen në dy fshatra, në fshatin Binçë/Biçe dhe Grapc/Grapce. Mirëpo, edhe pas dy vjetësh që kur janë kthyer ata nuk mund të lëvizin lirshëm. KFOR-i italian ka qenë vazhdimisht i pranishëm, kështu që edhe shqiptarët të cilët kanë dëshiruar t'i vizitojnë të kthyerit është dashur të kalojnë nëpër këtë vend kontrolli të rreptë. Të kthyerit nuk kanë marrë guximin të shkojnë jashtë këtyre vendbanimeve pa përcjellje. Kjo situatë ka ndryshuar vetëm pasi disa familje serbe janë kthyer në qytetin e Klinës.

Në fillim të marsit të vitit 2005 në qytetin e Klinës/Klina u kthyen familjet e para serbe. Për dallim nga rrethanat e fshatrava Binçë/Biça/ dhe Grapç/Grapce, këto familje nuk kanë pasur përcjelljen e përhershme të KFOR-it. Ata janë kthyer në shtëpitë apo banesat e tyre, por nuk janë vendosur në lagje të ndara, kështu që jetojnë në mesin e shqiptarëve. Tani kanë filluar të levizin lirshëm dhe pa përcjellje. Ata pohojnë se janë të kënaqur me lirinë e levizjes. Ja se çka tha për FDH i kthyeri Millosh Vasiq:

„Sa i përket lirisë së levizjes kjo nuk paraqet problem. Shkoj gjithkrah, flas shqip dhe serbisht dhe askush muk më shikon keq. I kam takuar disa fqinj të mi me të cilët bisedoj normalisht. Përndryshe na viziton policia e nganjëherë edhe KFOR-i. Unë u them se nuk kanë nevojë të vijnë sepse nuk kemi kurrfarë problemesh.“

Ngjashëm flet për FDH edhe i kthyeri Millorad Pavloviq:

„Raportet me fqinjtë shqiptarë nuk janë as të mira as të këqija. Me fqinjtë e ndërtesës sonë nuk kemi kontakte. Mirëpo, sikur ata kujdesen që assesi të mos na shkaktojnë probleme apo pengesa. Shpeshherë interesohem, kurse ata janë të qetë në korridor, madje nuk i kam dëgjuar të flasin zëshëm. Megjithatë, ende nuk kemi vendosur kontakte. Përndryshe, ne dalim plotësisht lirshëm, shkojmë në qytet dhe mund të blejmë gjësende në çdo dyqan. Deri tani asnjëherë nuk kemi pasur probleme. Shpeshherë shkoj në komunë dhe atje më shërbejnë si duhet. Madje njëherë pata shkuar në gjykatën komunale për ta marrë një dokument. Unë përndryshe flas shqip shumë mirë. Iu drejtova në shqip nëpunësit lidhur me dokumentin që më nevojitej e ai mu përgjigj në mënyrë shumë të kulturuar: „Uluni vetem pak, do ta rregullojmë“ (Sedite samo malo, sada ćemo to rešiti). Shumë shpejtë ma kryen punën dhe unë u ktheva në shtëpi. Shyqyr Zotit që deri tani nuk kemi pasur nevojë të shkojmë në shtëpinë e shëndetit, edhe pse mendoj se nuk do të kishim asfarë problemesh. Para disa ditësh Lepa Maziq kishte shkuar atje për t'u kontrolluar dhe siç më tha e kishin pranur shumë mirë, e kishin kontrolluar dhe përcjellë si është më së miri. Përkundër faktit se shumica e njerëzve që kanë jetuar në Klinë/Klini më njohin shumë mirë, megjithatë rrallë kush më përshëndet. Në të vërtetë kam kontakte me disa shqiptarë, por këtë e bëjmë në mënyrë mjaft diskrete.“

Gjatë vitit 2005 në Klinë/Klinu janë kthyer mbi 20 familje serbe. Kjo ka ndikuar që liria e levizjes të jetë më e mirë edhe për të kthyerit në fshatrat përrreth siç janë Binçë/Biça, Grapç/Grapac dhe Vidajë/Vidanje. Në lidhje me këtë mund të konkludojmë se liria e levizjes për serbët e Klinës/Kline është shumë më e mirë në krahasim me vitet e mëparshme. Mirëpo, edhe më tutje duhet punuar për promovimin e lirisë së levizjes dhe të lirive të tjera sidomos lidhur me raportet me institucionet lokale.

1.5. KOMUNA E PEJËS/PEĆ

Rrethanat në lidhje me lirinë e levizjes në komunën e Pejës edhe më tutje janë të pandryshuara. I vetmi fshat të cilin serbët lokalë nuk i kanë braktisur shtëpitë e tyre është fshati Gorazhdevc/Goraždevac. Megjithatë, Gorazhdevci/Goraždevac funksionon si enklavë. Në territorin e fshatit serbët levizin lirshëm, por janë të rrallë ata banorë të këtij

fshati që marrin guximin që në Pejë të shkojnë pa përcjellje. Duhet theksuar se situata në lidhje me lirinë e levizjes fare pak ka ndryshuar.

Situata është e njëjtë edhe me të kthyerit në tri fshatrat e komunës së Pejës. Në fshatin Bellopojë/Belo Polje, 24 serbë janë kthyer qysh në muajin shtator të vitit 2003. Edhe pse jetojnë vetëm dy kilometra larg qendrës së Pejës/Peçi assesi nuk mund të shkojnë lirshëm në këtë qytet. Natyrisht, gjendjen e kanë përkeqësuar edhe ngjarjet e marsit të vitit 2004. Më 18 mars 2004 është sulmuar edhe fshati Bellopojë/Belo Polje dhe me atë rast u është vënë flaka shtëpive të posandërtuara të serbëve.

Situata është diçka më e mirë në fshatrat Brestovik/Brestovik dhe Sigë/Siga, në të cilat procesi i kthimit ka filluar në shtator të vitit 2004. Në këto dy fshatra, për dallim nga Bellopoja/Belog Polja, nuk ekziston ndonjë punkt i KFOR-it apo i policisë. Në të vërtetë patrullat janë të shpeshta, por nuk ekziston punkti kontrollues. Të kthyerit ndihen mirë por edhe më tutje hezitojnë të shkojnë pa përcjellje në Pejë/Peçi. Ka përjashtime, megjithëse te të kthyerit mbretëron frika. Për FDH Dejan Jashoviq deklaroi sa vijon:

„Ende nuk kemi vendosur kontakte të afërta me fqinjët shqiptarë, edhe pse këtë do të duhej bërë. Kur shihemi karshi gjithësesi përshendetemi me ngritjen e dorës, si ata edhe ne. Jam i bindur se me fqinjët tanë nuk do të kemi probleme, sepse as ata me ne nuk kanë pasur asnjëherë probleme. Përndryshe, nuk mund të levizim nëpër tërë territorin e fshatit, kurse deri në fshatin Brestovik shkojmë pa probleme. Unë personalisht shkoj edhe më larg. Kur shkoj te familja në Mal të Zi udhëtoj këmbë deri në udhëkryqin e fshatit Vitomiricë. Aty e pres autobusin, zakonisht atë që vjen nga Prizreni, e ndali dhe në mënyrën më normale hyjë brenda dhe vazhdoj për në Mal të Zi. Këtë linjë e shfrytëzoj edhe më rastin e kthimit. Deri tani nuk më ka ndodhur që dikush të më shikojë keq. Mirëpo, ende nuk kemi marrë guximin që të shkojmë në Pejë pa përcjellje.“

Mund të konkludojmë se sa i përket lirisë së levizjes për pjesëtarët e bashkësisë serbe në komunën e Pejës nuk janë bërë përparime pozitive. Situata nuk është e ngjashme në asnjë rajon tjetër. Çdo kund janë shënuar rezultate pozitive në këtë plan, me përjashtim të kësaj komune.

2. Kthimi i të zhvendosurve

Gjatë vitit 2005 përfaqësuesit e Fondit për të Drejtën Humanitare kanë vizituar 21 vendbanime anë e mbanë Kosovës, në rajonet ku po zhvillohet procesi i kthimit. Në bazë të kësaj kemi ardhur në përfundim se ky proces gjatë vitit 2005, në krahasim me vitin paraprak, është shumë më i suksesshëm. Në përmirësimin e kësaj gjendjeje ka ndikuar edhe themelimi i Ministrisë për Bashkësitë dhe Kthim në kuadër të Qeverisë së Kosovës.

Hulumtuesit e Fondit për të Drejtën Humanitare kanë përcjellë kthimin e grupeve të pakicave në rajonet e përfshira nga trazirat etnike gjatë ngjarjeve të marsit të vitit 2004

dhe kanë kryer kërkime lidhur me kthimin e personave të zhvendosur në komunën e Klinës/Klina. Kthimi i pakicës serbe në Klinë e cila gjendet në verilindje të Kosovës, vetëm tani është bërë i mundur. Përpjekjet e mëhershme për kthimin e disa serbëve në Klinë/Klina (më 2003) qenë të pasuksesshme. Kthimin e tyre e kanë mundësuar autoritetet komunale duke ofruar mbështetje më të madhe. FDH ka dhënë njoftimin duke u bazuar në raportet nga terreni, duke theksuar se ky rast paraqet një hap përpara në zgjidhjen e problemit të kthimit.

Njoftimi është botuar në gazetën „Koha ditore“ të datës 5 korrik 2005.

2.1. KOMUNA E LIPJANIT/LIPLJAN

Komuna e Lipjanit/Lipljan është me popullësi të përzier; këtu jetojnë shqiptarët, serbët, ashkalinjtë, romët dhe kroatët. Komuna ka 72 fshatra, nga të cilat 52 janë me popullësi shqiptare, 6 me popullësi serbe dhe 13 me popullësi të përzier. Bashkësitë etnike kryesisht janë të koncentruara në qytetin e Lipjanit/Lipljanu dhe në fshatrat: Rubovc/Rabovce, Grackë/Staro Gracko, Medvec/Medvec, Allas/Mali Alas, Dobrotin/Dobrotin, Gushtericë e Ulët/Donja Gušterica, Gushtericë e Epërme/Gornja Gušterica, Livadh/Livade, Suhodoll/Suvi Do, Lepinë/Lepina, Janjevë/Janjevo, Magurë/Magura, Kroi i Goleshit/Goleško Vrelo dhe Dobrajë e Vogël/Malo Dobranje. Fshati me popullësi më të përzier është Novobërda/Novo Brdo. Në të krahas popullësisë shqiptare që është shumicë jetojnë edhe kroatët, romët dhe ashkalinjtë.

Komuna e Lipjanit/Lipljan ka rreth 80.830 banorë. Prej tyre 69.465 janë shqiptarë, 8.914 serbë, 1.632 ashkalinjë, 520 romë dhe 299 kroatë.

Nga viti 1999, kur në Kosovë kanë hyrë forcat ndërkombëtare të NATO-s, u shënuar një zhvendosje graduale e popullësisë serbe nga qyteti i Lipjanit/Lipljana dhe nga fshatrat përreth, si edhe e ashkalinjve dhe romëve.

Shpërngulja e serbëve ka filluar pas ngjarjeve të 17 marsit të vitit 2004. Pas lufte shumica e ndërtesave banesore të serbëve të shpërngulur nga Lipjani janë shkatërruar. Me atë rast u është vënë zjarri 1.792 shtëpive.

Nga viti 1999 deri 2002 në komunën e Lipjanit, me mjetet e organizatave dhe shoqërive të ndryshme (World Vision, ADRA, SDC, Diaconi, GOAL, UFORKU, KFOR), janë ndërtuar 555 dhe janë rindërtuar 521 shtëpi, kurse me mjetet vetiake janë ndërtuar 279 shtëpi. Edhe kanë kaluar më tepër se pesë vjetë nga përfundimi i luftës në Kosovë edhe më tutje ka mbetur në numër shumë i madh i personave të zhvendosur nga kjo komunë që ende nuk janë kthyer në vatrat e tyre. Gjatë periudhës 2000 deri 2004 në komunën e Lipjanit janë kthyer 413 serbë, 550 ashkalinjë dhe 48 romë.

Personeli komunal dhe administrata komunale nuk kanë qenë të kënaqur me numrin e të kthyerve, andaj janë ndërmarrë aktivitete për të krijuar një klimë të mirë politike për kthimin e personave të zhvendosur nga vatrat e tyre. Me pjesëtarët e shumicës shqiptare është biseduar për atë se në këtë hapësirë duhet të ketë vend për të gjitha bashkësitë e

kësaj komune dhe në këtë plan është arritur pëlqimi i plotë i polullësisë shumicë për pranimin normal dhe të natyrshëm të të zhvendosurve dhe të të shpërngulurve. Kujdes i veçantë i është kushtuar punësimit të pjesëtarëve të bashkësive etnike në organet e pushtetit lokal dhe në shërbimet civile. Në administratën komunale momentalisht punojnë rreth 185 shqiptarë dhe 32 pjesëtarë të bashkësive etnike. Njëri nga zëvendëskryetarët e komunës është nga radhët e bashkësisë serbe.

Kohëve të fundit nuk pati incidente serioze në baza etnike, pos një rasti kur para disa javësh persona të panjohur kanë shtënë me armë zjarri në drejtim të shtëpisë së një familjeje ashkalinje në fshatin Allas/Mali Alas.

Momentalisht është tejet aktual kthimi i ashkalinjve të zhvendosur nga fshati Magurë të cilët janë vendosur në kampin e Plemetinit.

„Me ashkalinjtë e zhvendosur nga fshati Magurë për herë të fundit kemi biseduar më 20 tetor të këtij viti. Pos meje në bisedime moren pjesë edhe përfaqësuesit e UNHCR-it dhe të UNMIK-ut. Ne ua kemi bërë me dije se kampi i Plemetinit do të mbyllet dhe se secili duhet të kthehet në shtëpinë në të cilën ka jetuar më herët, se komuna e Lipjanit ka siguruar trollin në të cilin do të ndërtohen shtëpitë për ta, se siguria është në nivel të lartë, se liria e levizjes është normale, se do të mundësohet shkollimit i barabartë për të gjithë dhe se në Magurë deri tani janë kthyer 50 familje ashkalinje që po jetojnë normalisht. Mirëpo, shumica e ashkalinjve nga fshati Magurë në kampin e Plemetinit janë të pakënaqur me ndërtimin e banesave për ta. Ata kishin vërejtje se nuk janë konsultuar për vendin në të cilin do tu ndërtohen banesat personave të kthyer dhe pse këto banesa nuk janë ndërtuar në Lipjan ose Obiliq, ku ekzistojnë mundësi më të mëdha për punësim.“

Profesori gjuhës ruse, zyrtar për kthim në komunën e Lipjanit/Lipljan

2.2. KOMUNA E KLINËS/KLINA

Si shembull më i suksesshëm i kthimit mund të merret rasti i kthimit në vetë qytetin e Klinës/Klina.

Kthimi i serbëve në Klinë/Klina ka filluar në këtë vit, edhe pse disa qytetarë të kombësisë serbe kanë tentuar të kthehen në dhjetor të vitit 2003. Ata qenë vendosur në fshatin Binçë, komuna e Klinës në të cilin jetojnë serbët.

Më 10 dhjetor 2003, 11 meshkuj nga fshati Binçë/Binçe kanë shkuar këmbë deri në Klinë/Klina. Janë vendosur në një shtëpi serbe, por shumë shpejtë aty është tubuar një numër i qytetarëve shqiptarë dhe ka protestuar për shkak të kthimit të paparalajmëruar,

duke e penguar në këtë mënyrë kthimin e serbëve në Klinë/Klina. Është dashur të kalojë një vit që në këtë qytet të mund të kthehet familja e parë serbe. Me ndihmën e DRC-së (Danish Refugee Council) dhe me ndihmën e pakursyer të Kuvendit të komunës së Klinës/Klina, familja e parë serbe u kthye në shtëpinë e vet në Klinë më 28 shkurt 2005. Çifti bashkëshortor Maziq ishte mjaft i kënaqur që ishte kthyer si dhe me tretmanin që ia kishin siguruar institucionit komunale. Po e citojmë një pjesë të deklaratës së të kthyerit M. M. dhënë FDH:

„Ne të dy, bashkëshortja ime dhe unë kemi qenë fatlum që jemi të parët që jemi kthyer në qytetin e Klinës. Na kanë pritur shumë mirë. Kur kryetari i komunës së klinës/Klina Ramë Manaj ishte njoftuar për kthimin tonë erdhi të na vizitojë dhe me atë rast na uroi mirëseardhjen. Për ne ishte rrethanë lehtësuese edhe fakti se shtëpia jonë nuk ishte dëmtuar. Në të kishte jetuar fqinji ynë shqiptar. HABITAT-i kishte kontaktuar me të dhe ai kishte shfaqur gatishmërinë që ta lirojë shtëpinë. Nuk kemi kontaktuar me fqinj të tjerë, pos me fqinun e parë. Sa për fillim jemi të kënaqur me këtë që na është ofruar.“

Familja e dytë serbe që është kthyer për të jetuar në Klinë/Klina e ka bërë këtë më 19 prill 2005. Kjo familje treanëtarëshe është kthyer në banesën e vet, duke kontaktuar më parë me njeriun i cili në atë kohë banonte në këtë banesë. Ai kishte shfaqur gatishmërinë që ta lirojë banesën. Të kthyerit janë tejet të kënaqur me lirinë e levizjes. I kthyeri M. P. kështu flet në lidhje me këtë:

„Unë levizi lirshëm nëpër Klinë/Klina. Më duhet të them se asnjëherë nuk kam përjetuar provokime. Vërtetë vetëm një numër i vogël i njerëzve më përshëndesin në rrugë, përkundër faktit se në Klinë/Klina e njohë një numër të madh të njerëzve, por unë mendoj se marrëdhëniet do të përmirësohen. Është me rëndësi se në rrugë askush nuk më ka provokuar. Lirisht shkoj për të blerë gjësende që më nevojiten nëpër shitore dhe tregtarët më shërbejnë si është më së miri.“

Deri tani në Klinë/Klina janë kthyer 19 famije serbe. Është interesant fakti se serbët në Klinë/Klina janë kthyer individualisht dhe jetojnë në vendbanime të ndryshme në afërsi të fqinjve të tyre shqiptarë. Ata lirisht levizin nëpër qytet, vizitojnë njëri tjetrin dhe kanë qasje në të gjitha institucionet e sistemit. Disa prej tyre kanë kërkuar ndihmën mjekësore në Shtëpinë e Shëndetit në Klinë/Klina dhe janë trajtuar shumë mirë nga ana e personelit mjekësor. Përkundër kësaj, jeta e pjesëtarëve të kombësisë serbe në Klinë/Klina nuk është e lehtë. Ndër prioritete ata e potencojnë rregullimin e çështjes së pronësisë së tyre, siç janë lokalet dhe shtëpitë si dhe punësimi. Ata janë të gatshëm të integrohen në shoqërinë kosovare dhe ti kryejnë obligimet e veta. Theksojnë se duhet ta paguajnë rrymën, telefonin dhe obligimet e tjera komunale por për këtë nuk kanë kurrfarë të ardhurash. Ky është problemi që më së shumti i mundon banorët e kthyer në komunën e Klinës/Klina.

2.3. KOMUNA E PEJËS/PEĆ

2.3.1. Fshati Bellopojë/Belo Polje

Në fshatin Bellopojë/Belo Polje afër Pejës/Peći kthimi i serbëve të zhvendosur ka filluar kah fundi i vitit 2003. Shtëpitë për 24 familje gati ishin përfunduar. Mirëpo, siç është e njohur në trazirat e masrsit qenë rrezikuar edhe serbët e kthyer nga ky fshat. Ata sërisht qenë të detyruar ti braktisin shtëpitë e tyre të posandërtuara të cilave më vonë u është vënë flaka. Një kohë banorët e fshatit Bellopojë/Belo Polje qëndruan në bazën ushtarake të KFOR-it italian e pastaj u kthyen në fshat. Shtëpitë e tyre u rindërtuan në shkurt të vitit 2005 me mjetet që i ndanë Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i komunës së Pejës/Peć. Pikëpamjet e banorëve të këtij fshati lidhur me kthimin janë të ndryshme. Disa pohojnë se ekzistojnë kushtet minimale për kthim të qëndrueshëm, kurse të tjerët mendojnë se nuk mund të jetojnë në këto kushte. Përfaqësuesi i fshatit për FDH e përshkroi me këto fjalë problemin e kthimit:

„Kjo çështje mund të zgjidhet shumë thjesht. E para, bashkësia ndërkombëtare duhet ta dijë se cilat janë nevojat më të domosdoshme që këtu duhet të plotësohen. Para së gjithash zhvillimi ekonomik. Pra, mbetet që të investohen mjete për tu hapur vende të reja pune. Nëse sigurohet mirëqenia dhe nëse të rinjtë kanë ku të punësohen ata edhe do të shoqërohen dhe askujtë nuk do t i bie ndërmend që t i bëjë keq tjetrit. Qeveria e Kosovës duhet më zëshëm ta bëjë me dije se pajtohet me kthimin e të zhvendosurve dhe pastaj do të jetë më lehtë. Njerëzit këtë do pranojnë shumë shpejt. Pastaj kthimi nuk guxon të keqpërdoret. Ekziston një organizatë Greke e cila është e gatshme të investojë për kthimin e serbëve. Ajo ka hartuar projektin për kthimin e 40 familjeve serbe në këtë fshat. Unë isha i tejet i kënaqur deri sa nuk e shikova regjistrin e atyre që do tu ndërtohen shtëpitë. Po ku i gjetën pikërisht ata? Që të gjithë kanë blerë shtëpi në Beograd që vlejné nga 200.000 euro e më tepër. Po ata kurr nuk do të kthehen për të jetuar këtu. Nga ana tjetër, ka serbë nga fshati ynë që sot e kësaj dite jetojnë në objekte kolektive dhe të cilët mezi presin që dikush këtu tua ndërtojë ndonjë kasollë. Ka të tillë që këtu i kanë varrosur fëmijët e vet dhe mezi presin të kthehen dhe këtu ta presin vdekjen. Pra, duhet pasur kujdes se kujt po i ndihmohet për tu kthyer.“

Megjithatë, në kthimin e të zhvendosurve në këtë fshat nuk ndikojnë vetëm kushtet e vështira ekonomike. Ky është një prej fshatrave në të cilin nuk ekziston liria e levizjes. Banorët e këtij fshati mund të levizin lirshëm vetëm brenda territorit të fshatit. Ekziston transporti i organizuar për ta që në ditët e caktuara të mund të shkojnë deri në Gorazhdevc/Goraždevca, ose më tutje deri në Mitrovicë/Mitrovice. Pikërisht për këtë edhe qasja në institucionet e sistemit është e kufizuar. Thënë qartazi, nëse ndonjëri prej banorëve të këtij fshati dëshiron tu drejtohet organeve komunale, atëherë së pari duhet të shkojë në Gorazhdevc/oraždevac, ku ekziston zyra e bashkësive dhe që përmes saj tu drejtohet organeve përkatëse.

2.3.2. Fshatrat Sigë dhe Brestovik/Siga i Brestovik

Fshatrat Sigë dhe Brestovik/Sela Siga i Brestovik gjenden vetëm tre kilometra larg qytetit të Pejës/Peći. Banorët e këtyre dy fshatrave fqinje janë të nacionalitet serb. Të kthyerit e parë arritën në Brestovik/Brestovik në shtator të vitit 2004. Të njëjtin muaj arritën edhe të kthyerit e parë në fshatin Sigë/Siga. Kthimin e tyre e ka financuar organizata italiane „Bergamo“, kurse punimet për ndërtimin e shtëpive i ka kryer Qeveria Gjermane „THW“. Levizja e lirë e të kthyerve është e kufizuar, në të vërtetë ata mund të levizin lirshëm në territorin e këtyre fshatrave, edhe pse ka përjashtime. I kthyeri D.J. nga fshati Sigë deklaroi për FDH sa vijon:

„Prej se kemi ardhur këtu në këtë fshat nuk pati punkt, kështu që kush ka dashur ka mund të vijë në fshat. Pjesëtarët e SHPK patrollojnë shpesh. Vijnë te ne dhe na pyesin se a kemi probleme etj. Me ne sillen në mënyrë tejet korrekte. Shpeshherë vijnë për të pirë së bashku me ne kafe. Patrullat janë të përziera, përkatësisht të përbëra nga shqiptarë dhe boshnjakë. Madje na kanë thënë se do të na sjellin edhe disa aplikacione për ata që dëshirojnë të punojnë në shërbimin policor. Nuk jam i sigurtë se ndonjëri do të paraqitet, edhe pse mendoj se do të ishte mirë që edhe ndonjë serb të hyjë në SHPK. Edhe KFOR-i patrullon gjatë natës. Megjithatë, duhet pranuar se që nga ardhja jonë këtu e deri më tani nuk na ka ndodhur asnjë incident. Në të vërtetë, me një rast disa të rinj kanë gjuajtur gurë mbi shtëpinë e një serbi duke i thyer disa tjegula. Por unë mendoj se këtu nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë incident serioz. Ne këtu ndihemi të sigurtë.

Siç deklaroi deklaroi ky dëshmitar për FDH, situata në fshatrat Brestovik/Brestovik dhe Sigë/Siga është diç më e mirë se në fshatin Bellopojë/Belo Polje. Deri sa në Bellopojë/Belom Polju vazhdimisht janë të pranishëm pjesëtarët e KFOR-it italian, në fshatrat Brestovik/Brestovik i Siga/Siga patrullat janë vetëm të kohëpaskoshme. Sidoqoftë, levizja e lirë nuk është në nivelin e kënaqshëm. Kah fundi i vitit 2005 këto fshatra i ka vizituar kryeministri Bajram Kosumi, i cili u ka premtuar të kthyerve se Qeveria e Kosovës do të bëjë çmos për përmirësimin e kushteve jetësore të të kthyerve. Në kuadër të këtyre përmirësimeve është ndërtuar edhe shkolla fillore për fëmijët e personave të kthyer.

2.4. KOMUNA E VUSHTRRIË/VUÇITRN

Menjëherë pas përfundimit të luftës më 1999, pothuajse të ashkalinjtë e braktisën Vushtrrinë/Vuçitrn, për shkak të incidenteve, vrasjeve dhe zhdukjeve të disa pjesëtarëve të bashkësisë së ashkalinjve. Mirëpo, pas një viti njerëzit kanë filluar të kthehen në shtëpitë e tyre. Numri i ashkalinjve të kthyer në Vushtrri/Vuçitrn ka shkuar duke u shtuar vazhdimisht. Në mars të vitit 2004 në Vushtrri/Vuçitrn jetonin 320 pjesëtarë të bashkësisë së ashkalinjve, përkatësisht rreth 100 familje. Në fillim e kishin të kufizuar

lirë e levizjes. Vetëm diku rreth gjysmës së vitit 2003 situata u përmirësua. Njerëzit vinin në qytet për të blerë gjësende nëpër duqanet e shqiptarëve.

Mirëpo, më 18 mars 2004 ashkalinjtë e Vushtrrisë/Vučitrna ishin në shënjestër të shqiptarëve lokalë. Me atë rast janë djegur dhe shkatërruar të gjitha shtëpitë e tyre. Pjesëtarët e bashkësisë ashkalinje janë evakuuar në bazën e KFOR-it francez në fshatin Magjunaj. Punimet për rindërtimin e shtëpive të tyre vazhduan deri më 22 dhjetor të vitit 2004. Mirëpo, procesi i kthimit të tyre ka qenë mjaft i ngadalshëm. Lidhur me këtë për FDH përfaqësuesi i ashkalinjeve të Vushtrrisë deklaroi:

„Njerëzit nuk kthehen nëpër shtëpitë e tyre sepse ende nuk janë krijuar kushtet e duhura. Një prej parakushteve janë edhe muret e oborreve. Askush nuk dëshiron të kthehet deri sa nuk rrethohen oborret e tyre. Për këtë është lejuar një shumë e mjeteve, por kjo nuk mjafton. Pastaj shtëpitë nuk janë të pajisura, kështu që në këtë dimër nuk mund të jetojmë në to, ngase nuk ka nxemje e shumë gjëra të tjera të domosdoshme. Megjithatë unë kam vendosur që të kthehem në shtëpinë time rreth datës 1 mars. Nuk kam zgjidhje tjetër. Shpresoj që edhe të tjerët të ndjekin shembullin tim. Mendoj se do të kthehen 4-5 familje, e për të tjerat nuk jam i sigurtë. Për kthim është shumë e rëndësishme edhe liria e levizjes, e cila momentalisht për ne është e kufizuar. Unë megjithatë levizi, edhe pse shpeshherë më bëhen provokime verbale. Për shembull, para disa ditësh disa të rinj kur më shikuan mu drejtuan me këto fjalë: „Ende jeni këtu?“ Liria e levizjes është parakusht qenësor për kthimin tonë. Përndryshe, siguria nuk është në nivel të kënaqshëm, ngase që nga viti i ri e këndej dyert e shtëpive tona sërish janë thyer.“

Sipas fjalëve të pjesëtarëve të bashkësisë ashkalinje, për t'u mundësuar kthimi i tyre është e domosdoshme që vetëdija e popullësisë shumicë të jetë në nivel më të lartë dhe që në të ardhmën të mos ushtrojnë dhunë ndaj tyre. Ata thonë se nuk ia vlenë që vazhdimisht t'i ruajë policia. Përveç lirisë së levizjes ashkalinjtë i brengosë edhe situata e rëndë ekonomike dhe papunësia e madhe që i godet të gjithë në Kosovë.

2.5. KOMUNA E RAHOVECIT/ORAHOVAC

2.5.1. Fshati Zoqishtë/Zočište

Në komunën e Rahovecit/Orahovac deri tani kthimi është bërë kryesisht në mënyrë spontane. Mirëpo, është ndërmarrë iniciativa për kthimin e 41 familjeve serbe në fshatin Zoqishtë/Zočište. Në të vërtetë, këto familje kanë shprehur gatishmërinë që të kthehen. Duke pasur parasysh këtë gatishmëri të tyre, Ministaria për Kthim dhe Pakica e Qeverisë së Kosovës ka hartuar projektin me të cilin është paraparë që në fshatin Zoqishtë/ Zočište të ndërtohen 44 objekte për banim, 41 për serbët e kthyer dhe tre për shqiptarët, pastaj ambulanca dhe infrastruktura komplete. Për këtë qëllim Qeveria e Kosovës ka siguruar 1.800.000 euro. Ndërtimi i objekteve banesore në Zoqishtë/Zočištu filloi kah mesi i muajit gusht të këtij viti, kurse në këtë moment janë në fazën përfundimit të ndërtimit 35 shtëpi. Ambulanca tani më është ndërtuar. Është ndërtuar kanalizimi, rrjeti i ujësjellësit dhe janë vendosur shtyllat për ndriçim publik të fshatit, kështu që tani janë në përfundim

e sipër të gjitha punimet në infrastrukturë. Kanë mbetur pa u kryer nëntë objekte që sipas planit të Ministrisë duhet të kryhen në muajin mars të vitit 2006. Shtëpitë e ndërtuara për ata që do të kthehen janë të madhësive të ndryshme, varësisht nga numri i anëtarëve të familjes. Për familjet me vetëm dy anëtarë janë paraparë shtëpitë prej 48 m², ndërkaq ato më të mëdha që janë paraparë për familjet me më shumë anëtarë kanë nga 78 m².

Sa i përket qasjes në institucionet lokale, ekziston zyra rajonale e Ministrisë për Kthim dhe pakica, ndërkaq në fshatin Hoçë e madhe/Velika Hoča ekziston dega e kësaj zyreje, kështu që nëpërmjet këtyre dy zyrave serbët lokalë në Rahovec/Orahovcu i zgjidhin problemet e tyre në shërbimet e ndryshme komunale.

2.6. KOMUNA E OBILIQIT/OBILIC

2.6.1. Kampi i Plemetinit/Plemetina

Në këtë moment në kampin e Plemetinit/Plemetina janë të vendosura 36 familje rome, ashkalinje dhe serbë që kanë ardhur si refugjatë nga Kroacia.

Kampin vazhdimisht ndokush e viziton. Në fillim të vitit këtë kamp e ka vizituar Bajram Kosumi, me që rast pati premtuar se banorët nuk do ta presin dimrin në këtë kamp dhe se ai do të mbyllet në qershor të vitit 2005. Menjëherë pastaj në afërsi të këtij kampi filloi ndërtimi i gjashtë banesave për familjet e refugjatëve nga Kroacia, por jo edhe për romët dhe ashkalinjtë e Magurës të vendosur në këtë kamp. Për ta ende nuk është gjendur zgjidhja, sepse në vend që të fillojë ndërtimi në Lipjan/Lipljanu, siç ishte premtuar, filloi ndërtimi i një shtëpie në Magurë/Magura.

Kryetari i komunës së Lipjanit/Lipljan me bashkëpunëtorët e vet e vizitoi kampin dhe me atë rast u bisedua lidhur me kthimin.

„Ne atëherë patëm thënë se nuk duam të kthehemi në fshatin Magurë/Magure, sepse atje nuk ka kushte për jetë. Nuk është shkak frika nga shqiptarët, por para së gjithash, pamundësia e punësimit. Mbretëron një krizë e madhe për punë jo vetëm për romët, por edhe për shqiptarët dhe të tjerët. Pastaj edhe fëmijët tanë janë mësuar këtu. Ata mësimin e vijnë në gjuhën serbe e jo shqipe. Këtu e kemi edhe kujdesin shëndetësor, ndërkaq nuk jemi të sigurtë se atje do të mund ta realizojmë kujdesin shëndetësor.

Ishim në fshat dhe biseduam me vendasit shqiptarë lidhur me kthimin tonë. Ishte i pranishëm edhe nënkryetari i komunës së Lipjanit/Lipljan, zyrtari për çështjet e kthimit dhe të tjerë. Ata na thanë se punë do të ketë meqë do të privatizohet miniera. Unë me atë rast u thash se, po që se miniera privatizohet, së pari do të punësohen shqiptarët, ngase edhe ndër ta ka shumë të papunësuar, kurse pronari privat neve nuk do të na pranojë në punë. Me atë rast u lajmëruan për kthim nëntë familje ashkalinje dhe rome, kurse 12 familje të tjera rome refuzuan të kthehen duke theksuar se edhe më tutje do të qëndrojnë në kampin e Plemetinit/Plemetine. Për kthim u paraqitën familjet e Muhamet Sharkit, Halil Mujës, Fazli Mujës, dy vllëzër nga Lipjani. Krahas meje nuk u pajtuan të kthehen

familjet e Gazmend Ramadanit, Shahe Berishës, Xhemajl Berishës, Esma Berishës, Kader Ajetit, Hysni Shaqirit, Ramadan Shaqirit, Muhamet Shaqirit dhe serbja nga Magura Verica Kërstiq.

Tani nuk e di cili është numri i saktë i romëve të fshatit Magurë/Magure, ngase çdo gjë është përzier. Disa deklarohen si ashkalinjë, të tjerët si egjiptasë. Para lufte nuk ka ekzistuar kjo dukuri, të gjithë kanë qenë romë.

Një është e saktë, këtu në kampin e Plemetinit kanë mbetur 12 familje rome nga Magura të cilat nuk dëshirojnë të kthehen.“

Hysni Shaqiri, rom nga fshati Magurë/Magure

Verica Kërstiq është e vetmja serbe nga Kosova e cila banon dhe jeton në kampin e Plemetinit/Plemetine, së bashku me 146 romë dhe ashkalinjë kosovarë të zhvendosur nga Lipjani/Lipljana, Obiliqi/Obilića, Skenderaj/Srbice, Fushë Kosova/Kosovog Polja dhe nga vende të tjera të Kosovës dhe disa refugjatë serbë nga Kroacia. Më heret në këtë kamp ka pasur shumë më tepër njerëz, ndoshta pesë-gjashtë mijë refugjatë dhe të zhvendosur. Verica Kërstiq erdhi këtu në vitin 1999 nga fshati Magurë, ku ka jetuar dhe punuar në kuzhinën e restorantit të minierës së magnezitit në Magurë/Magura. Shtëpinë e vet e kishte braktisur së bashku me shumë të tjerë nga frika dhe ngase nuk ndiheshin të lirë.

„Nuk kemi qenë të sigurtë, jo nga fqinjët shqiptarë, por nga njerëz të panjohur civilë që në Magurë vinin nga fshatrat e tjera. Ata neve serbëve, romëve dhe ashkalinjve na maltretonin dhe fyenin duke na thënë „më nuk keni çka të kërkonin këtu“.

Te mjeku mund të shkojmë pa kurrfarë problemi. Kur kemi nevojë shkojmë në ambulancën e Plemetinit. Ata na pranojnë mirë, na japin reçeta, por shumica nuk mund ti blejnë ilaçet sepse nuk kanë para. Si mundet dikush me 50 euro të sigurojë miellin, sheqerin, vajin dhe ti paguajë ilaçet, e këtu shumica janë të moshuar dhe të sëmurë, kurse disa prej familjeve kanë numër të madh të fëmijëve. Organizata humanitare 'Nëna Tereze', e cila vepron këtu, sipas nevojës organizon shkuarjen në spitalin e Prishtinës. Sa i përket shëndetësisë, mund të them se nuk ka probleme. Vlen të theksohet se fëmijët lirisht e vijojnë mësimin.“

Verica Kërstiq, serbe nga fshati Magurë/Magure

2.7. KOMUNA E MITROVICËS/MITROVICA

2.7.1. Mahalla e romëve

FDH përcolli çështjen e kthimit të personave përkohësisht të zhvendosur të bashkësisë rome që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës, si dhe të shtëpive të tyre të rrënuara në Mahallën e romëve. FDH më tepër ka qenë i përqendruar në evakuimin e tyre nga kampi për shkak të helmimit nga plumbi. Për këtë arsye FDH ka ndërmarrë iniciativën për nënshkrimin e peticionit që romët që jetojnë në këto kampe menjëherë të evakohen. Peticionin e përkrahën 120 përfaqësues të orgnizatava nga mbarë bora, duke përfshirë edhe Amnesty International dhe Refugee International, si dhe mbi 600 individë nga të cilët rreth 200 prej tyre i takojnë bashkësisë etnike rome, ashkalinje dhe egjiptase në Kosovë. Në përpjekjet për vetëdijësimin e opinionit, FDH organizoi me 4 maj të vitit 2005 debatin publik lidhur me të cilin kanë shkruar edhe mediat. Në këtë debat diskutoi edhe avokati Andi Dobrosi nga Qendra për të Drejtat e Romëve e Evropës, me të cilin FDH ka bashkëpunuar më qëllim të vetëdijësimit të opinionit hetimit të rastit. Shumë organizata joqeveritare dhe përfaqësuesit e institucioneve morën pjesë në këtë debat. Gjatë këtij debati FDH ua ndau transkriptet të gjithë faktorëve relevantë.

Këtë iniciativë e kanë përkrahur këto organizata:

European Roma Right Center – ERRC

Advocacy Training and Resource Center – ATRC

Kosovo Roma Refugee Foundation – KRRF

International War and Peace Reporting – IWPR

Youth Initiative for Human Rights – YIHR

Dy ishin temat kryesore për diskutim:

1. Masat e mundshme ligjore të shkaktuara nga pakujdesia në lidhje me helmimin
2. Peticioni ndërkombëtar për evakuimin e kampit



Fotografitë nga debati lidhur me helmimin nga plumbi në kampet e romëve në pjesën veriore të Mitrovicës, të mbajtur më 4 maj 2005.

Teksti i peticionit:

Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Qendra për të Drejtat e Romëve e Evropës, ju ftojnë që ti bashkoheni peticionit për evakuimin urgjent të kampit të romëve në pjesën veriore të Mitrovicës. Shëndeti i fëmijëve romë është në rrezik. Fëmijët romë dhe lehonat në kampet e Zhitkovcit, Çesminllug/ Česmin Lug dhe Kabllarë/Kablare (Veriu i Mitrovicës) janë në rrezik që të helmohen nga plumbi. Sipas raportit të Organizatës Shëndetësore Botërore, në tetor të vitit 2004 në kampin Zhitkovc/Žitkovac, toka në disa vende ishte e ndotur 100,5 mbi nivelin e lejuar, kurse në lagjën Çesminllug/Česmin Lug situata është edhe më e rëndë dhe e tejkalon kufirin e lejuar për 359,5 herë. Këta fëmijë duhet të largohen për shkak të rrezikut të helmimit – MENJËHERË. Përkundër situatës politike, lutën të gjithë akterët që ta analizojnë situatën nga aspekti humanitar. Tani kur IPV dhe UNMIK-u garantojnë rindërtimin e shtëpive në Mahallën e romëve, do të ishte më lehtë që të binden familjet rome që ta braktisin këtë kamp pa u frikësuar në lidhje me rindërtimin e shtëpive të tyre.

FDP ka orgnaizuar konferencën për shtyp më 2 shtator të vitit 2005 me që rast e prezntoi edhe peticionin në fjalë. Në këtë konferencë foli Dajana Post nga Qendra për të Drejtat e Romëve e Evropës, e cila paralajmëroi padinë për prokurorin publik të Kosovës, e ngritur kundër personave NN.

Konferencën për shtyp e ndoqen tri televizione kombëtare në Kosovë: RTK, TV21 dhe KTV.

2.8. KOMUNA E PRIZRENIT/PRIZREN

Në mbledhjen e fundit të grupit të punës për kthim dhe integrim të Kuvendit të komunës së Prizrenit më 27 tetor u miratua projekti me vlerë 665.000 euro, për kthimin e 13 familjeve serbe, katër shqiptare dhe një rome nga fshati Sërbicë e Ulët.

Prema tom projektu biće obnovljene kuće koje su posle ulaska NATO trupa na Kosovo juna 1999. potpuno uništene. Selo Donja Srbica je nacionalno mešovito, a od Prizrena/Prizren je udaljeno desetak kilometara. Smešteno je pored magistralnog puta koji povezuje Prizren/Prizren i Đakovicu/Gjakovë. Pre rata, u selu Donja Srbica/Sërbicë e Ulët živeo je 1.151 Albanac, 99 Srba i nekoliko pripadnika RAE zajednice. Živeli su dobro, odnosi Srba sa Albancima i Romima bili su vrlo dobri i mogli su da služe za primer. Međutim, posle rata, nakon dolaska međunarodnih snaga na Kosovo, svi Srbi su zbog straha napustili svoje domove.

2.8.1. Fshati Sërbicë e Ulët / Donja Srbica

Në Sërbicë të Ulët/Donju Srbicu deri tani nuk është kthyer asnjë serb. Shumica dëshirojnë të kthehen në shtëpitë e tyre. Për këtë arsye në fshat janë organizuar për tua krijuar kushtet për kthim. Sreqko Cvetković është zgjedhur për përfaqësues të serbëve të Sërbicë të Ulët/Donja Srbica. Në këtë cilësi ai mori pjesë në të gjitha bisedimet lidhur me hartimin e projektit për kthimin në shtëpitë e tyre të serbëve të zhvendosur. Duhet theksuar se të gjitha këto biseda me strukturat komunale dhe ndërkombëtare dhe me shqiptarët banorë të fshatit Sërbicë e Ulët/Donja Srbica, kanë qenë tejet korrekte. Ky projekt të cilin e kanë hartuar bashkërisht bazohet në dëshirat reale për kthimin e të zhvendosurve serbë nga ky fshat, e të cilët janë vendosur në vende të ndryshme nëpër Serbi.

Sëbashku me përfaqësuesit e Zyrës për Bashkësitë etnike të komunës të Prizrenit/Prizren dhe organizatës humanitare ICMC, e cila do ta zbatojë këtë projekt, është vendosur kontakti me 21 familje serbe të zhvendosura nga Sërbica e Ulët. Në këto bisedime 13 kryefamiljarë të këtyre familjeve shfaqen dëshirën që të kthehen në shtëpitë e tyre. Në bazë të kësaj u hartua projektdokumenti për kthimin e 13 familjeve. Dëshirën për kthim e kishin shfaqur 25 familje, por për shkak të mungesës së mjeteve materiale ky projekt u reduktua në 13. Të gjithë serbët e Sërbicës së Ulët e pranuan projektdokumentin. Në lidhje me të nuk pati vërejtje serioze, pos që shtëpitë e reja do të kenë sipërfaqe më të vogël nga sipërfaqja e shtëpive të rrënuara. Ata propozuan një plotësim të vogël të këtij projekti. Kërkuan ndërtimin e ujësjetës ngase banorët nuk kanë ujë. Ky propozim nuk u pranua meqë është paraparë ndërtimi i bunarëve, edhe pe konsiderohet se kjo nuk është zgjidhja më e mirë për këtë fshat i cili ka një numër të madh familjesh, ndërmjet 120 e 150 sosh. Për të gjitha këto familje nuk do të mjaftonin këta bunarë ngase nuk mund të sigurojnë një furnizim të mjaftueshëm me ujë të pijes. Përfaqësuesi i fshatit në mbledhjen e fundit të grupit të punës sërish propozoi që në këtë fshat uji të silllet nga Pirana/Pirana ose nga Landovica/Landovica. Kjo do të ishte një zgjidhje fatlume, nga se bëhet fjalë për ujësjetës e qytetit.

Kushtet për kthim ekzistojnë dhe njerëzit janë të gatshëm të kthehen, por mungojnë mjetet për ndërtimin e shtëpive të rrënuara. Në Sërbicë të Ulët/Donjoj Srbici edhe më tutje nuk ka serbë. Ata janë të zhvendosur nëpër tërë Serbinë: Beograd, Nish, Kragujevc dhe në disa vende më të vogla.

Gjatë intervenimit të NATO-s në Sërbicë të Ulët/Donjoj Srbici, krahas serbëve vendas kishte edhe 800 shqiptarë të zhvendosur nga fshatrat e afërta, më së shumti nga Pirana/Pirana, Landovica, Zojza/Zojca, Mamushë/Mamuse dhe nga fshatra të tjera më të vogla. Ata qëndruan këtu afër një muaj dhe pasi u harxhua ushqimi vendosën të largohen. Askush nuk i ka ndjekur, por ishte dëshira e tyre që të largohen për shkak të mungesës së ushqimit.

„Unë kam kërkuar nga ICMC që ta organizojnë edhe një takim të përbashkët me përfaqësuesit e të gjitha fshatrave përreth me persona pak më të moshuar që janë me autoritet në mënyrë që me ta të merremi vesh për të konstatuar gjendjen e vërtetë. Ne

serbët nga Sërbica e ulët/Donje Srbice nuk turpërohem dhe nuk i frikohem kthimit, sepse asgjë nuk kemi bërë, përkundrazi kemi bërë vetëm mirë për këtë shoqëri dhe për këtë popull, andaj do të ishtë mirë që të bisedohet dhe të gjendet një zgjidhje. Unë mendoj se zgjidhja mund të gjendet, sepse këtu edhe pas ardhjes së trupave të NATO-s nuk pati sulme as ndaj serbëve e as ndaj shqiptarëve. Së bashku kemi jetuar mjaft mirë dhe këtu nuk kishte patur dallime. Kemi mbrojtur dhe kurajuar njëri tjetrin. Në fshatin tonë, për dallim prej fshatrave të tjera, askush nuk është rrahur, vvarë, rrëmbyr e maltretuar, sepse ne kemi qëndruar në vijën e mbrojtjes. E kemi mbrojtur këtë popull dhe pasi ata shkuan, edhe ne edhe ata kemi qajtur dhe për askend nuk ishte krejt një.

Aktivitetet e shumta që i kemi zhvilluar kohëve të fundit, sidomos kontaktet me banorët shqiptarë të fshatit, treguan se situata e gjithmbarshme e sigurisë është e pranueshme për kthim, se ekziston dëshira e ndërsjellë për bashkëpunim dhe se popullsia shqiptare e miraton kthimin e serbëve në vatrat e tyre. Unë besoj se kthimi i serbëve të zhvendosur në Sërbicë të Ulët do të jetë i suksesshëm.“

Sreqko Cvetković – profesor i matematikës, fshati Sërbicë e Ulët/Donja Srbica – Prizren/Prizren

3. Qasja e barabartë në institucione, qasja në shërbimet publike, në edukim dhe punësim, përdorimi i gjuhës amtare

Institucionet ligjëvënëse, Qeveria e Kosovës, UNMIK-u

Më 19 korrik 2005¹ i dërguari special i sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, zotëri Soren Jesen-Petersen dhe kryeministri i Kosovës, zotëri Bajram Kosumi, hartuan kornizën strategjike për bashkësitë dhe kthim për vitin 2005, në prani të përfaqësuesve të partive politike, grupit të kontaktit, UNMIK-ut, organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile.

Zotëri Bajram Kosumi shprehu gatishmërinë e Qeverisë së Kosovës që të merr përgjegjësinë për qytetarët e Kosovës.

¹ Më detajisht shih; UNMIK Press release 1394, e martë, 19 korrik 2005.

Më 10 janar 2005, përfaqësuesi i lartë i sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara emëroi këshilltarin për çështjet e pakicave, kanadezin Xhenes Krejgun.

Ky emërim kishte për qëllim përkrahjen e PLSP për integrimin e pakicave kosovare në krijimin e një Kosove multietnike, gjë që fokusohet në çështjet e lidhura me plotësimin e standardeve dhe kultivimin e një dialogu të përhershëm ndërmjet bashkësive etnike në Kosovë.

Krejg Xhenes u ngarkua për sigurinë, kthimin, decentralizimin dhe lirinë e kthimit. Ai i raporton PLSP të Kombeve të Bashkuara dhe në bashkëpunim të përhershëm me koordinatorin për standarde dhe nëpunësit e tjerë të UNMIK-ut.²

Në bazë të Kornizës kushtetuese nga maji i vitit 2001, Kosova vendosi administrimin multi-etnik që nga 13 qershori i vitit 2002. Në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në 30 komuna në vitin 2004 u themelua Parlamenti i Kosovës prej 120 deputetësh të zgjedhur më 23 tetor 2004. i cili deri tani ka miratuar 85 ligje.

Sipas të dhënave të OSBE-së³, nga raporti i saj i dhjetorit të vitit 2005, Kuvendi i Kosovës përpiqet të nxjerrë ligje për të krijuar një shtet juridik, është i angazhuar për nxjerrjen e ligjeve (27 ligje të miratuara në vitin 2004) dhe për zbatimin e tyre në të gjitha nivelet.

Nga trembëdhjet ministritë, zotëri Sadik Idrizi nga koalicioni Vakaf që e përbëjnë përfaqësuesit e pakicave të ndryshme etnike është ministër i Shëndetësisë, kurse Slavisha Petković nga Iniciativa Qytetare Serbe, është ministër për kthim dhe bashkësitë, në të cilën punojnë 140 punëtorë dhe 82 volunterë. Kjo Ministri hapi zyrat lokale në gjashtë vende të Kosovës, në Kamenicë/Kamenici, Mitrovicë/Mitrovici, Shtërpcë/Štrpcu, Rahovec/Orahovcu/ Hoçë të Madhe/Velikoje Hoçi dhe në Prilluzhë/Priluzhju.

Deri në prill të vitit 2005 Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) numronte 6.282 policë dhe këtë 84,15 % meshkuj dhe 15,85 % femra. Prej tyre 84,5 % shqiptarë, 9,4% serbë dhe 6,1% nga bashkësitë e tjera etnike, të shpërndarë në 26 stacione policore.

Në Trupat Mbrojtëse të Kosovës pakicat janë të përfaqësuara me rreth 6,1 %; 46 janë serbë, 43 myslimanë, 13 kroatë, 13 turqë, kurse pjesa tjetër e kësaj përqindjeje janë romë, egjiptasë dhe ashkalinjë.

Në Kosovë janë 398 gjyqtarë dhe prokurorë lokalë, nga të cilët 18 janë serbë dhe 22 nga bashkësitë e tjera etnike, kurse 24 gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë punojnë në 88

² UNMIK Press Release 1297, e hënë, 10. janar 2005.

³ OEBS raporti i muajit dhjetor 2005 për implementimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës – Raporti II, ligjet që janë shpallur në vitin 2004, 27 ligje i nxorri Kuvendi i Kosovës, mbi të cilat OSBE-ja e kishte mbështetur raportin.

raste. Konsiderohet se përfaqësimi i bashkësive etnike në personelin gjyqësor të Kosovës me vetëm 4,4 % është i pamjaftueshëm.

Shëndetësia

Ekzistojnë spitale në të gjitha rajonet, përkatësisht në të gjitha qendrat e mëdha: Prishtinë/Priştina, Mitrovicë/Mitrovica, Gjakovë/Đakovica, Prizren/Prizren, Pejë/Peć dhe Gjilan/Gnjilane, si dhe ambulancat në të 30 komunat e Kosovës.

Në shëndetësi janë të punësuar 13.500 veta, duke përfshirë edhe 1000 serbë. Nëpër fshatrat e Kosovës shërbimet e veta i ofrojnë ambulancat e vogla.

Arsimi

Gjithsej 42.000 fëmijë e vijnë në mësimin në 1200 shkolla. Rreth 15.000 studentë i ndjekin studimet në dy universitete të Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin mbi arsimin dhe aftësimin e të rriturve.⁴ Ekzistojnë disa shkolla në gjuhën boshnjake që punojnë sipas programit mësimor shqip dhe dy degë të Universitetit të Prishtinës veçmas për studentë boshnjakë të vendosura në Pejë/Peć dhe Prizren/Prizren. Përkundër faktit se ka pasur plane që studentëve boshnjakë tu mundësohet përcjellja e mësimin në gjuhën shqipe në univerzitet, kurse provimet ti japin në gjuhën boshnjake, këtë universiteti nuk e ka bërë, kështu që studentët boshnjakë edhe më tutje e kanë të vështirë të vazhdojnë studimet në universitetet e tjera të rajonit. Po ashtu, ndihet mungesa e teksteve shkollore – edhe pse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i ka botuar disa tekste, por kjo nuk mjafton.

Një prej problemeve të pranishme që kanë të bëjnë me gjuhët është problemi i arsimimit të fëmijëve të bashkësive etnike në gjuhën amtare. Deri sa fëmijët serbë që i kanë afër shkollat mësimin zakonisht e vijnë në shkolla paralele që i financon dhe mbikqyrë Ministria për Arsim dhe Sport e Sërbisë, kurse edhe fëmijët turqë mund të vijnë në mësimin në shkollat me mësim në gjuhën turke, bashkësitë e tjera nuk marrin kurrfarë ndihme në këtë drejtim. Në këtë drejtim romët kanë më së shumti probleme, pasi nuk ekzistojnë shkolla e as tekste shkollore sipas të cilave fëmijët e tyre do të mësonin në gjuhën rome. Sikur edhe për çështjet e tjera, bashkësia rome në Kosovë nuk është sa duhet e fuqishme që të merr mjete të mjaftueshme financiare apo ndonjë lloj ndihme tjetër për hapjen e së paku një klase në shkollën fillore ose për përgatitjen e teksteve në gjuhën rome.

Ashkalinjtë dhe egjiptasit shkollohen në shkollat në gjuhën shqipe, kështu që pjesëtarët e këtyre bashkësive ankohen se pesëtarët e këtyre grupeve etnike nuk mund të identifikohen sa duhet me kombin e vet.

⁴ Ligji numër (02/L- 24) në nenin 13 lidhur me jodiskriminimin thotë:: Vijuesit e moshuar kanë të drejtë të trajtohen pa kurrfarë diskriminimi mbi baza etnike, sipas bindjeve politike e fetare, prejardhjen kombëtare e shoqërore, përkatësinë gjinore dhe aftësinë e kufizuar.

Goranët të cilët jetojnë kryesisht në komunën e Dragashit/Dragaš, që është pjesa më jugore e Kosovës, edhe më tutje kanë probleme me arsimimin në gjuhën e tyre. Fëmijët e goranëve do të mund të vijonin mësimin në gjuhën serbe, për shkak të ngjashmërisë me gjuhën e tyre, por shumica e shkollave serbe në pjesën qendrore dhe veriore të Kosovës është tepër larg për pjesëtarët e bashkësisë së goranëve.

Edhe pse trenin që udhëton nga Kosova qendrore dhe Leshaku/Leška në pjesën veriore të Kosovës e shfrytëzojnë edhe pjesëtarët e bashkësive etnike dhe shqiptarët, vetëm linjat

speciale të autobusëve qarkullojnë ndërmjet enklavave të caktuara dhe veriut të Mitrovicës/Mitrovice, nga njëherë me përcjellje policore ose me përcjellje të KFOR-it, e nga njëherë pa përcjellje, ngase autobusët publikë që kalojnë nëpër këto enklava nuk ndalen në këto mjedise. Në disa rajone të Kosovës perëndimore, autobusët e KFOR-it i transportojnë njerëzit jashtë këtyre enklavave vetëm njëherë në javë. Autobusët shkollorë për fëmijët serbë dhe romë udhëtojnë nëpër viset e banuara me popullatë shumicë shqiptare me përcjellje të SHPK ose policisë së UNMIK-ut.

Në këtë situatë problem paraqet edhe liria e levizjes e cila, edhe pse është përmirësuar në krahasim me periudhën e mëhershme, nuk është e kënaqshme. Liria e gjithmbarshme e levizjes për serbët dhe romët në shumë mjedise në të cilat dominon popullata shqiptare edhe më tutje po përmirësohet shumë ngadalë dhe ende është shumë larg nga niveli i kënaqshëm. Edhe më tutje disa fshatra të banuara me serbë dhe romë janë të izoluara dhe në to ende janë të pranishme punktet kontrolluese të KFOR-it.

Pensionet dhe ndihma sociale

Popullësisë së Kosovës i takon e drejta në pension dhe kjo është e rregulluar me Rregullorën e UNMIK-ut nr. 2001/35, për pensionet në Kosovë, si dhe me Ligjin që e ka miratuar Kuvendi i Kosovës, mbi shërbimet sociale dhe familjare.⁵ Qeveria e Kosovës ka filluar pagesën e pensioneve në korrik të vitit 2002, menjëherë pas miratimit të ligjit të përmendur. Të drejtën në pension e shfrytëzojnë rreth 100.000 veta, prej tyre 18 % janë pjesëtarë të bashkësive etnike. Niveli i tashëm i pensionit është 40 euro në muaj.

Ndihma sociale sillet prej 34 deri 62 euro në muaj, varësisht nga numri i anëtarëve të familjes dhe nga kriteret e tjera. Vlen të theksohet se të drejtën në ndihmën sociale e gëzojnë rreth 200.000 qytetarë.

Gjuhët

Secila komunë duhet t'i sigurojë përkthyesit për përkthimin e materialeve dhe të mundësojë përdorimin e gjuhëve të të gjitha bashkësive që jetojnë në atë komunë. Kjo është e rregulluar me Rregullorën e UNMIK-ut nr. 2000/45.⁶

⁵ Ligji nr. 02/L-17

⁶ Rregullorja e UNMIK-ut mbi vetëqeverisjen komunale, neni 9 – Gjuhët, pikat 9.5 Statuti i komunës dhe rregulloret mbi gjuhët e bashkësive.

Gazeta zyrtare botohet rregullisht së paku një herë në muaj në gjuhën shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe angleze. Shih Ligjin mbi Gazetën zyrtare të Kosovës.⁷

Në televizionin publik RTK emetohen, në kohë të caktuar, programe në gjuhët e pakicave, kohë kjo që tani është shtuar. RTK ofron programin e lajmeve dhe programe kulturore në gjuhë të ndryshme disa herë në ditë. Mirëpo, këto programe nuk paraqesin mënyrën më të mirë për informimin e pakicave lidhur me ngjarjet më të rëndësishme ose për çështjet e tjera që kanë të bëjnë me bashkësinë e caktuar. Kjo ka të bëjë me radiostacionet lokale. Më 1 qershor 2005, katër radiostacione në rajonin e Mitrovicës filluan të emetojnë programe ditore në gjuhën rome, boshnjake dhe turke me ndihmën financiare të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Programet i emetojnë dhe punët e tjera rreth përgatitjes së lajmeve i kryejnë gazetarët e këtyre bashkësive, me shpresë se në këtë mënyrë do të përmirësohet depërtimi i informatave deri te vetë këto bashkësi. Mirëpo, bashkësia turke dhe rome ankohen se nuk kanë gazeta në gjuhën e tyre.

Ombduspersioni

Në Kosovë ekziston institucioni i *ombduspersionit*,⁸ e sipas raportit të pestë për periudhën 2004–2005 që i është dërguar PSSP më 13 korrik 2005, janë regjistruar 446 ankesa.

⁷ Ligji nr. 2004-47, neni 3 – Gjuhët.

⁸ Institucioni i Ombduspersionit është themeluar nga UNMIK-u Regullorën nr. 2000/38 (30qershor 2000), për përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Prej datës 11 korrik 2000, sipas rekomandimeve të kryesuesit austriak të OSBE-së, përfaqësuesi special i sekretarit të Kombeve të Bashkuar (PSKB) e ka emëruar Marek Antonio Novickin për ombduspersion në Kosovë. Prej 15 shtatorit të vitit 2000 PSSP emëroi edhe tre zëvendës (z. Nik Lumezin, z. Ljubinko Todoroviqin dhe zonjën Dona Gomijen).

Institucioni i ombduspersionit është inauguruar formalisht më 21 nëntor 2000. Ky institucion i është përkushtuar promovimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në të punon personeli lokal, ndërkaq rreth 30% të anëtarëve janë nga radhët bashësive etnike.

Institucioni i ombduspersionit pranon ankesat e të gjithë atyre që mendojnë se janë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe shkeljes së detyrës zyrtare, dhe zbaton hetimet lidhur me këto raste. Gjuhë zyrtare në këtë institucion janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze. Ai angazhohet që personit i cili ankohet ti ofrojë shërbimin në gjuhën e tij/saj, madje edhe atëherë kur nuk bëhet fjalë për ndonjërin nga gjuhët e përmendura. Përmes punës së vet institucioni angazhohet për promovimin e të drejtave të njeriut dhe të një administrate të mirë në Kosovë dhe të kontribuojë që kjo administratë të jetë transparente dhe e hapur për opinionin. Shërbimet e ombduspersionit janë gratis.

Qasja në institucionin e ombduspersionit është siguruar nëpërmjet zyrës kryesore në Prishtinë/rištini dhe zyrave në terren në Gjilan/Gnjilanu, Pejë/Peći, Mitrovicë/Mitrovici dhe Prizren, kurse nga muaji shkurt 2005, po ashtu edhe në Graçanicë/Gračanici. Zyrat në terren i udhëheqin kryesisht nga një ose dy juristë dhe nga një asistent juridik/përkthyes. Zyra në Mitrovicë/Mitrovici e ka nënzyrën e vet në pjesën veriore të qytetit.

Në shkurt të vitit 2005 është hapur zyra e re në terren në Graçanicë/račanici, që ka për detyrë të sigurojë një qasje me të lehtë në institucionin e ombduspersionit për shumë pjesëtarë të

Janë organizuar bisedimet me përfaqësuesit e të zhvendosurve dhe refugjatëve në Maqedoni, Serbi, Malin e Zi dhe në kampin e Plemetinit. Të gjitha këto rrethana kanë ndikuar që situata në këtë komunë të jetë e volitshme. Pjesëtarët e komuniteteve pakicë lëvizin lirë në Lipjan, por edhe në fshatra ku janë të vendosur. Mund të përdorin lirë gjuhën e vet dhe të gjitha dokumentet mund t'i marrin në gjuhën e tyre amtare.

3.1.1. Fshati Rubovc / Rubovce – Lipjan/ Lipljan

Fshati Rubovc/Rubovce, i cili gjendet dy-tre kilometra nga rruga magjistrale Prishtinë/Priština – Shkup/Skoplje, dhe i vendosur në mes të qendrave komunale Lipjan/Lipljan dhe Ferizaj/ Uroševac, gjysmën e popullatës e përbëjnë familjet shqiptare, ndërsa gjysmën tjetër ato serbe. Marrëdhëniet e serbëve dhe shqiptarëve në këtë fshat kanë qenë gjithmonë të mira.

Nga lufta e këndej nga fshati Rubovc janë larguar dhjetë familje serbe dhe ata nuk janë kthyer. Serbët e tjerë, shumica e tyre, këtu jetojnë shumë mirë. Kanë lëvizje të lirë dhe i punojnë tokat e tyre. Zotëri Etem (Murat) Uskoku, tregëtar nga fshati Rubovc për FDH deklaroi:

„Vitin e kaluar kemi organizuar akcion të përbashkët për asfaltimin e rrugës Rubovc-Lipjan. Në financimin e kësaj rruge kanë marrë pjesë vetëm shqiptarët, ndërsa sebet jo, por rrugën e kemi asfaltuar dhe tash e përdorim të gjithë“.

3.2. KOMUNA E GJILANIT/GNJILANE

3.2.1. Fshati Ponesh/Poneš

Fshati Ponesh/Poneš ka rreth 200 amvisni serbe dhe rreth 130 shqiptare. Para lufte këtu kishte më shumë serbë në krahasim me tash. Disa prej tyre janë larguar më herët dhe kanë ndërtuar shtëpi në Serbi. Të tjerët janë larguar para arritjes së forcave ndërkombëtare në Kosovë, por shumica kanë mbetur këtu.

Tash situata është shumë e mirë. Në Ponesh/Poneš nuk ka probleme ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Serbët lëvizin lirë, i punojnë tokat e tyre dhe shoqërohen me shqiptarë. Ekziston edhe shkolla e përbashkët ku mësimin e vijnë fëmijët shqiptarë dhe serbë. Në këtë shkollë mësimin e vijnë rreth 40 nxënës shqiptarë, të cilët çdo ditë gjenden nën të njëjtin kulm me mbi 100 nxënës serbë. Serbët mësojnë sipas plan-programeve të Serbisë, kanë koordinatoren e tyre dhe shkolla e tyre quhet „Sveti Sava“. Shqiptarët kanë koordinatoren e tyre dhe mësojnë sipas plan-programeve të Kosovës. Kjo shkollë më herët është quajtur „Zenel Hajdini“, kurse tash „Ibrahim Urviq.

bashkësive etnike. Kjo zyrë është bërë operative më 1 mars 2005 dhe është themeluar vetëm duke i falënderuar donacionit të Agjencisë për Zhvillim të Ministrisë Austriake të Punëve të Jashtme.

Kjo nuk u pengon as shqiptarëve e as serbve, por u ndihmon që më lehtë të organizojnë aktivitete të përbashkëta. Arsimitarët dhe nxënësit, shqiptarë dhe serbë shoqërohen, si në shkollë ashtu edhe në fshat. Nuk ka incidente në baza etnike. Situata është shumë më e mirë në krahasim me situatën e mëhershme.

U inicua akcioni i ndërtimit të godinës së re shkollore, të cilën do ta shfrytëzojnë bashkarisht, shqiptarët dhe serbët. Në muajin gusht 2005 është asfaltuar rruga, por kjo rrugë kalon nëpër pjesën e fshatit ku janë të vendosura shtëpitë e serbëve, ndërsa përfundon aty ku fillojnë shtëpitë shqiptare.

„Nuk e di kush ka vendosur kështu, sepse kjo nuk është mirë dhe nuk pranohet as nga ana serbe e as nga ne shqiptarët. Gjithashtu, krijon përshtypje të keqe edhe ambulanta e këtuashme, ku mjeku vjen dy herë në javë vetëm për serbët, ndërsa ne duhet të shkojmë deri në Gjilan.“

Sadik (Nuri) Sulejmani, mësues pranë Shkollës Filllore „Ibrahim Urviq“ (Zenel Hajdini) në fshatin Ponesh

3.3. KOMUNA E RAHOVECIT/ORAHOVAC

3.3.1. Fshati Zoqisht/ Zočište

Ndërtimi i objekteve banesore në Zoqisht/Zočištu, komuna e Rahovecit/ Orahovac, ka filluar kah mesi i gushtit 2005, ndërsa tani është në fazën përfundimtare ndërtimi 35 shtëpive. Ndërtimi i ambulancës tani më ka përfunduar. Është ndërtuar kanalizimi, rrjeti i ujësjetillit dhe janë vendosur shtyllat për ndriçim publik të fshatrave dhe faktikisht të gjitha punimet në infrastrukturë janë në përfundim e sipër. Kanë mbetur të papërfunduar nëntë objekte, të cilët sipas planit të ministrisë janë paraparë të përfundojnë në mars të vitit të ardhshëm. Në realizimin e këtyre planeve ka ngecje, kryesisht për shkak të motit të ligë, por edhe për shkaqe financiare, ngase obligimet financiare nuk kanë pasur mundësi të përcjellin dinamikën e punëve. Shtëpitë e ndërtuara për të kthyerit janë të madhësive të ndryshme, në varshmëri nga numri i anëtarëve të familjës. Për familje që kanë vetëm dy anëtarë të familjës është paraparë shtëpia prej 48 m², ndërsa shtëpitë më mëdha janë janë të dedikuara për familjet shumëantareshe, me sipërfaqe prej 78 m².

Procesi i zbatimit të standardeve në Kosovë është vazhdim. Në bazë të hetimeve të FDH, pushteti lokal në Kosovë në mënyrë intenzive punon për funksionimin normal të institucioneve demokratike-sundimin e ligjit, lirinë e lëvizjes, kthimin e qëndrueshëm dhe të drejtën pronësore.

Prezenca e pakicave në institucionet publike në komunën e Rahovecit/ Orahovac, në bazë të statusit të tyre demografik mund të shihet në këtë tabelë:

Numri i anëtarëve dhe përbërja etnike obligative e bashkësive:

	%	Gjithësej	Shumica	Pakicat
Komiteti për pol. dhe financa	11,1 %	9	8	1
Komiteti për komunitete	55,5 %	9	4	5
Komiteti për ndërmjësime	55,5 %	9	4	5

Përqindja e pjesmarrjës së pakicave – në raport me ndarjen proporcionale të buxhetit në komunën e Rahovecit duhet të jetë 3,1 % pakica. Momentalisht në Rahovec/Orahovac pakicat janë të përfaqësuara rreth 7,6 %, në administratë 15,8 %, në arsim 5,6 %, shëndetsi 10,4 %.

Komuna e ka tejkaluar përqindjen e ndarjes proporcionale të buxhetit për nevojat e pakicave (3,1 % është ndarje e drejtë proporcionale, ndërsa është shpenzuar 6,15 % e buxhetit.)

Burimi: raporti lidhur me zbatimin e standardeve, komuna e Rahovecit/ Orahovac

„Unë pas pesë vitesh, në muajin korrik për herë të parë e kam vizituar fshatin Zoqisht/Zočište. Banorët më kanë pranuar mirë. Më kanë pyetur se nga jam dhe kanë thënë se secili duhet të kthehet në shtëpi të vet. Madje më kanë pyetur edhe për një serbe, e cila ka punuar në ambulancën e fshatit Zoqish, për të cilën kishin fjalë të mira shfaqën dëshirën që ajo të kthehet dhe të punojë në fshatin e tyre. Ajo është nga Hoça e Madhe/Velika Hoça. Emri i saj është Cveta, ndërsa mbiemrin nuk e di dhe momentalisht punon në Shtëpinë e Shëndetit në Hoçë të Madhe/Velikoj Hoçi. Dy përfaqësues të serbëve të zhvendosur nga Zoqishta/Zočište, Pavle Stojanoviq dhe Gjorgje Mishi, sot për herë të parë, pas konfliktit të armatosur në Kosovë kanë vizituar shtëpitë e tyre në fshat. Ata kanë ardhë me ndihmën e Komitetit për krijimin e kushteve për kthim në komunën e Rahovecit/Orahovac dhe UNHCR-it. Ata ishin me të vërtetë të kënaqur me rindërtimin e objekteve të shkatërruara. Ata shprehën gatishmërinë për tu kthyer dhe kanë deklaruar se të kthyerit e parë do të jenë Jovo Jovanoviq dhe Gjorgje Kërstiq shtëpitë e të cilëve janë të rindërtuara.

Mendoj që kthimin në fshatin Zoqisht/Zočište do të jetë i suksesshëm, dhe ne që kemi mbetur këtu, e veçanërisht popullata shqiptare duhet të tregojmë mirëkuptim dhe gatishmëri për pranimin e personave të zhvendosur dhe organet komunale të sigurojnë edhe kushte të tjera për kthim, siç është punësimi, veçanërisht zhvillimi i vreshtarisë, për çka ekzistojnë kushte ideale.“

Tatjana Kolashinac – koordinator i Zyres rajonale e Ministrisë për kthim dhe pakica në Rahovec/Orahovac

FDH ka përcjellur bisedimet e Komisionit këshillëdhënës të Këshillit të Evropës me pjesëtarë të bashkësive etnike, të mbajtur në Prizren më 13 tetor 2005, në sallën për konferenca të misionit OSBE-s.

Të pranishëm: anëtarët e Komisionit këshillëdhënës të Këshillit të Evropës Asbjern Eide, kryetar i Komitetit këshillëdhënës (i cili përfaqëson Norvegjinë), Anastazija Grikli (Irlandë) dhe Zhgjislav Galicki (Poloni), Anti Korkeckivi (sekretar ekzekutiv i Konventës Kornizë) dhe Stefani Marshal, administrator.

Perfaqësuesit e bashkësive etnike: Refki Alija, Boshnjak, OJQ „Lëvizja për të Drejtat e Qytetarëve“, Prizren, Iskender Muzbeg, avokat, turk nga Prizreni, Nuhi Tahirovci, goran nga Dragashi, Besnik Avdosaj, rom nga Prizreni, anëtar i grupit punues për kthimin e romëve në komunën e Prizrenit, Nexhip Menekshe, rom nga Prizreni, OJQ „Durmish Aslano“, Branislav Krstiq, Serb nga Prizreni, Taner Bojnik, turk nga Prizreni, Zyra për komunitete, Qerim Bajrami, boshnjak, NGO „Vrelo“, Reçan, Emilija Rexhepi, boshnjake, NGO „Equality“, Prizren, Ibrahim Elshani, rom nga Prizreni, revista „Alavo Romane“, Gani Elshani, hashkali nga Prizreni, NGO „Inicijativa 6“, Musa Saliju, boshnjak nga Prizreni, përfaqësues i punëtorve të arsimit, Fikrim Dimka, turk, përfaqësues i punëtorëve të arsimit dhe Abdi Alija, goran nga Dragashi, NGO „Human Ecology“. Në bisedime kanë marrë pjesë përfaqësuesit e UNMIK-ut dhe OSBE-s. Edhe pse ishin të ftuar nuk morën pjesë përfaqësuesit e fshatit Novake, në të cilin ka pasur kthim të organizuar të serbëve.

Shumica e përfaqësueseve të komuniteteve kanë paraqitur shembuj pozitiv, duke theksuar që Korniza Kushtetuese u garanton pakicave të drejtat e tyre individuale dhe kolektive, që Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin kundër diskriminimit, që pakicat në Kosovë kanë partitë e tyre politike të cilat veprojnë në mënyrë aktive, që dalja në zgjedhjet e fundit ka qenë e kënaqëshme (përveç serbëve, shumica e tyre i ka bojkotuar zgjedhjet) që në Parlamentin e Kosovës janë shtatë deputetë, një ministër dhe një anëtarë i Kryesisë së Kosovës dhe që ata në rajonin e Prizrenit angazhohen për integrim. Ata theksuan se ekziston liria e lëvizjes, që janë të sigurtë, duke përfshirë edhe një numër serbësh që janë kthyer në qytet, në rrethin e Prizrenit në fshatin Novak, Draçiq, Smaq, Stajkovc, Sredskë etj.

Gjithashtu, kanë theksuar që lirshëm e përdorin gjuhën e tyre, fëmijët e tyre mësojnë në gjuhë amëtare (përveç romëve), përdorin simbolet e tyre dhe informohen në gjuhën e tyre. Radio Prizreni, radio stacionet „Yeni Donem“, „Omega“ dhe „Astra“ emetojnë programe në gjuhën turke, boshnjake dhe rome. Ekziston gazeta e pavarur në gjuhën boshnjake „Alem“, ndërsa botohen edhe publikime të ndyshme periodike në gjuhët e pakicave.

Megjithatë, ekzistojnë edhe shembuj të shumtë që pengojnë përparimin e këtyre proceseve. Shumë vërejtje u drejtuan në llogari të institucioneve lokale, të cilat ndonjë herë nuk tregojnë gatishmëri për t'i zgjidhur çështjet esenciale të pjesëtarëve të pakicave. U theksua që stema e komunës së Prizrenit është shkruar vetëm në gjuhën shqipe dhe angleze, por edhe jo edhe në gjuhët e pakicave. Rendi i ditës dhe procesverbalet nga

mbledhjet e Kuvendit hartohen vetëm në gjuhën shqipe. Në tubimet publike flitet vetëm shqip, ndërsa nuk sigurohet përkthyesi. Mbishkrimet e dokumenteve të rëndësishme si dhe mbishkrimet e rrugëve, gjithashtu shkruhen vetëm në gjuhën shqipe. Në institucionet lokale pakicat nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate. Në Bordin e drejtorëve të Komunës nuk gjendet asnjë përfaqësues nga radhët e serbëve, boshnjakëve, romëve, hashkalinjëve dhe egjiptasëve.

Vërejtje të shumëta kanë të bëjnë me punësimin dhe arsimimin e pjesëtarve të bashkësive etnike.

Është theksuar që popullata shumicë nuk tregon vendosmëri më të madhe për pranimin e komuniteteve dhe që këto të fundit nuk tregojnë interesim të duhur për integrim, gjë që është pasojë e të kaluarës së trashëguar.

4. Dhuna/incidentet e motivuara në baza etnike-racore

Gjatë vitit 2005 FDH ka përcjellur incidentet, respektivisht sulmet ndaj pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë, numëri i të cilave shënon rënie në krahasim me vitin paraprak. Numëri më i madh i sulmeve është shënuar mbi pasurinë e pjesëtarëve të komunitetve pakicë, por gjithashtu ka pasur edhe sulme ndaj pjesëtarëve të komuniteteve. Shprehur në përqindje më së tepërmi sulme janë kryer mbi pjesëtarët e komunitetit serbë, ndërsa pastaj në pjesëtarët e bashkësive RAE., por ka pasur edhe sulme mbi pjesëtarët e komuniteteve të tjera pakicë, duke përfshirë edhe shqiptarët që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës.

4.1. Vrasja e avokatit Ibish Çakall nga Prizreni/Prizren

Avokati Ibish Çakall është vrarë të martën, më 11 tetor 2005, para banesës së tij në Prizren, në rrugën e Gjerdapit nr.4, rreth orës 19,30. Kryesit e krimit nuk janë të njohur. Pjesëtarët e Sherbimit Policor të Kosovës(SHPK), policisë së UNMIK-ut dhe prokurorisë ende nuk kanë të dhëna për motivet e kryerjes së kësaj vrasjeje.

Sipas deklaratës së anëtarëve të familjës, Ibishi pas iftarit së bashku me bashkëshorten e tij da dalë nga banesa me qëllim që të shkojë për vizitë te miqët. Kur kanë zbritur nga banesa, bashkëshortja e tij është kthyer në banesë për të marrë diçka që ka harruar. Ibushi ka mbetur para banesës duke pritur. Ajo pas disa minutash ka zbritur dhe e ka gjetur bashkëshortin të shtrirë 20 metra larg hyrjes së banesës. Duke menduar që Ibishi i është sëmurë, ka shkuar në ndërtesën e afërt, gjithashtu në rrugën e Gjerdapit, ku jeton kushëriri i Ibishit, Adnan Kazasi për të kërkuar ndihmë. Pas disa minutash ata arritën para ndërtesës ku ishte i shtrirë Ibishi, por vendin e kishin rrethuar pjesëtarët e SHPK, të cilët nuk lejuan që t'i afrohen trupit. Bashkëshortja e Ibishi nuk ka parë dikë të dyshimtë për vrasjen e bashkëshortit të saj e as nuk ka dëgjuar të shtëna.

Të nesërmën policia ka kumtuar që një pjesëtarë i tyre, duke kaluar rrugës së Gjerdapit, në lagjëm Ortakoll e ka vërejtur Ibish Çakall të shtrirë në rrugë dhe e ka dërguar në

spitalin e Prizrenit, por ai rrugës ka vdekur. Ibishi ka pasur dy plagë tejshpuese, njëren në pjesën e stomakut, ndërsa tjerën në dorën e djathtë. Mbi te, sipas të gjitha gjasave është shtënë me armë ngulfatëse. Policia dhe organet hetuese deri më tani nuk kanë informata lidhur me këtë vrasje.

Vrasja e avokatit Ibish Çakall është vrasja e parë e një pjesëtari të komunitetit turk në teritorin e komunës së Prizrenit.

Me rastin e vrasjes së Ibish Çakall, Oda Rajonale e Avokatve të Prizrenit, më 13 tetor 2005 mbajti mbledhje komemorative, me ç'rast është kërkuar që organet kompetente t'i zbulojnë kryesit e këtij krimi dhe të dërgohen para organeve të drejtësisë.

FDH, i cili ka hetuar këtë rast ka arritë që të marrë informata lidhur me vrasjen e avokatit të përmendur, pjesëtar i komunitetit turk në Prizren/Prizen.. Theksojmë deklaratën e avokatit, z. Lulzim Bilurdagiu, kryetar i Odës Rajonale e Avokatëve të Prizrenit:

„Atë ditë, para vrasjës së Ibishit, para zyres së tij e cila gjendet 50 metra përballës zyres sime, është vërejtur një numër i madh i serbve. Numri ishte shumë më i madh në krahasim me ditët e paraprake. Në një moment ishin së paju 15 klijentë të tij të cilit kishin ardhur për të zgjidhur kontestet e tyre të shitblerjes. Pa marrë parasysh këtë, unë nuk mendoj që ai është vrarë për shkak të këtyre punëve, por kjo është vrasje politike. Mendoj që vrasja nuk është kryer rastësisht, në kohën kur Prizrenin e ka vizituar zëvendës kryeministri dhe Ministri i punëve të jashtme të Turqisë, Abdullah Gul. Gjithashtu, vrasja ka ndodhur në kohën e përgatitjeve intensive për fillimin e bisedimeve lidhur me statusin përfundimtarë të Kosovës, kur bashkësia turke gjithnjë e më tepër integrohet në shoqërinë kosovare..

Ibishi ishte anëtarë i kryesisë së Partisë Demokratike Turke të Kosovës (Demokratik Turk Partisi KDTP) të degës së kësaj partie në Prizren. Ai u angazhua për mbrojtjen e interesave të turqëve në Kosovë dhe është angazhuar profesionalisht dhe politikisht për përparimin e shoqërisë kosovare në përgjithësi. “

4.2. Sulmi ndaj katër të rinjsh serbë në rrugën Ferizaj /Uroševac– Shtërpc / Štrpce

Sulmi më i rëndë ka ndodhur më 27 gusht 2005 në rrugën magjistrale Ferizaj-Shtërpc. Atë ditë, rreth orës 21, katër të rinjë të nacionalitetit serb udhëtonin me veturën e tyre nga Lipjani/Lipljan në drejtim të Shtërpcës/Štrpce. Mbi veturën e tyre është shtënë nga një veturë tjetër e cila ishte duke lëvizur. Me këtë rast janë vrarë Ivan Dejanoviq, i lindur në Prilluzhë, komuna Vushtëri dhe Akelsandar Stankoviq, i lindur në fshatin Konjuh, komuna Lipjan. Është plagosur rëndë Nikolla Dukiq nga Lagja e Re afër Lipjanit, ndërsa plagë të lehta ka psuar Aleksandar Janiçijeviq nga Shtimja/Štimlje. Shkëpusim nje pjesë të deklaratës së Aleksandar Janiçijeviq dhënë FDH.

„Rreth orës 21.10 në rrugëm Ferizaj-Shtërpc, në afërsi të një ure, kemi vërejtur pas nesh një veturë të zezë. Në një moment, tek një kthesë kemi dëgjuar diçka, nuk kemi ditur çka po ndodhë, por e kemi vërejtur që goma e përparme e djathtë është shpërthyer. Pastaj jemi ndalur dhe kur vozitësi Aleksandri vendosi ta hapë derën, ajo veturë e zezë është

ndalur paralelisht me veturën tonë. Unë isha i ulur pas nga ana e djathtë. Është shtënë nga një pushkë automatike. Unë isha i goditur me tre plumba në dorën e djathtë. Nuk di ku ishin të goditur të tjerët. Të shtënat nuk zgjatën shumë, pastaj edhe pesë minuta vetura qëndroi atje. Ne nuk lëviznim. Nuk kam dëgjuar bisedën e sulmuesve, ishte qetësi. Pas pesë minutash vetura e zezë vazhdoi rrugën për në Shterpca. Më pas Nikolla Dukiq mbi Aleksandrin arriti që ta kthej veturën. Aleksandri, vozitësi dhe Ivan Dejanoviq nuk japnin shenja jete. Meqenëse vetura kishte ndëruesin automatik të shpejtësisë, Nikolla këmbën vet e vendosi mbi këmbën e Aleksandrit e cila gjendej mbi papuçen e shpejtësisë. Në këtë mënyrë arriti që ta lëvizë automjetin deri në afërsi të një pompe benzine. U ndalëm 500 metra larg pompe me qëllim që ta drejtojmë unë veturën, me që Dukiq befasi filloi të ketë gjakderdhje gjithnjë e më shumë.“

Këtë krim e kanë dënuar të gjitha institucionet ndërkombëtare e vendore dhe partitë politike në Kosovë. Megjithatë, hetimi i policorë nuk ishte i suksesshëm dhe deri më sot askush nuk është i dyshuar për këtë vepër të neveritshme.

4.3. Sulmi mbi patrullën policore

Gjithashtu, në këtë aksin rrugor ndodhën edhe dy incidente. Së pari është rrënuar përmendorja e dëshmorëve të UÇK, disa qindra metra më largë nga vendi i ngjarjes të incidentit të parë, më 9 shtator 2005 u sulmua patrulla SHPK nga Shterpca/Štrpce. Tre policë që ishin në veturë i takonin komunitetit serb. Ata gjendeshin në detyrë të rregullt, duke patrulluar në këtë pjesë të rrugës nga Shterpca deri në fshatin Doganoviq, ku kufizohet Shterpca me Kaçanikun. Ata kanë vërejtur disa persona tek përmendorja e dëshmorëve të UÇK, e cila ishte e rrënuar, disa metra më larg në rrugë ishte e vendosur një barikadë e vogël prej gurësh. Në momentin kur e kanë zvogëluar shpejtësinë e automjetit, për të kaluar më lehtë pengesën, mbi veturë është shtënë nga arma automatike. Me këtë rast është plagosur polici Sasha Durlleviq, i cili atë natë e drejtonte veturën policore. Një kolege e tij për FDH e përshkruan incidentin me këto fjalë:

„ Ishte rreth orës 23.30 kur arritëm tekpërmendorja. Aty gjendeshin dhjetë persona (dy gra dhe shtatë meshkuj) të cilët ndiznin qirinjë. Kjo na dukej shumë e çuditshme. Dihet që shqiptarët nuk ndezin qirinjë në varreza e as në përmendore. Vendosëm që të mos ndalemi ngase e gjithë situata ishte mjaft e dyshimtë. Para disa minutash aty qëndronte një njeri i armatosur, ndërsa tani në mesnatë ishin nëntë njerëz. Kur arritëm para përmendorës, kemi vërejtur që disa metra para nesh ishte vendosur barikadë nga një grumbull gurësh. Këtë gjatë largimit nuk e kemi vërejtur dhe për këtë nuk na kanë informuar policët e UNMIK-ut, të cilët aty kanë kaluar disa minuta më herët. Sasha e kishte ngadalsuar veturën, por përnjëherë e kuptoi që jemi në rrezik dhe e nisi veturën me shpejtësi. Arritëm që t'i shmangemi barikadës nga ana e majtë e rrugës ku kishte më pak gurë. Para se të kalonim barikadën mbi ne është shtënë. Kemi dëgjuar disa zëra dhe erën e barutit. Unë dhe Novica i thonim Sashës „, vozit më shpejtë, ikim“. Ai vozitëte si i çmendur. Pastaj kam vërejtur që Sasha ka gjakderdhje dhe gjaku zgjërohej në këmishën e tij në pjesën e djathtë të shpinës“.

As lidhur me këtë incident hetimi nuk është kryer. Kjo ka ndikuar në rritjen e frikës të pjestarëve të komunitetit serbë që të qarkullojnë në këtë rrugë, veçanërisht gjatë orëve të mbrëmjes. Gjatë pas kësaj ngjarjeje këtë pjesë të rrugës Ferizaj-Shtërpcë e kanë kontrolluar forcat e KFOR-it, UNMIK-ut dhe SHPK-së.

4.4 Sulmi ndaj kolonelit të SHPK-së Dejan Jankoviç

Më 28 shtator 2005 ndodhi edhe një sulm i armatosur ndaj pjesëtarit të Shërbimit Policor të Kosovës, ndaj kolonelit Dejan Jankoviç. Jankoviç është i vetmi kolonel pranë SHPK-së nga radhët e komunitetit serb. Ai është nga fshati Vërbeshticë, komuna e Shtërpcës. Ai është komandant i SHPK-së i Shtabit rajonal për Gjilanin. Ditën kritike ai dhe kolegu i tij kanë udhëtuar me veturë zyrtare nga Gjilani në drejtim të Shtërpcës. Diku rreth orës 18.00 kalonin rrugën në mes të fshatit Kaçnik i Vjetër dhe Bellograc, të cilët i takojnë komunës së Kaçanikut. Në këtë aks rrugorë mbi ta është shtënë nga pusia. Koloneli Dejan Jankoviç ngjarjen e ka përshkruar kështu:

„Në një kthesë të madhe prej 180 shkallësh Novica e ka ngadalësuar veturën. Shpejtësia nuk ishte më e madhe se 30 km në orë. Në të dyja anët e rrugës ishte pylli. Përnjëherë, nga ana e djathtë e rrugës në largësi prej 10 metrash mbi ne është shtënë nga armë zjarri. Kanë shtënë dy persona ndoshta edhe më shumë, por unë nuk kisha mundësi t'i shoh ata. Kamë vërejtur se është shtënë nga dy drejtimet nga pusia. Jo zyrtarish kam kuptuar që mbi ne janë shtënë 50 plumba, prej të cilëve gati gjysma e ka gotitur veturën tonë. Unë isha i goditur në dorë dhe në pjesën e djathtë të gjoksit. Novica nuk ishte i lënduar. Ai ka vozitur veturën e dëmtuar edhe 200 metra, ndërsa pastaj jemi rokullisur nën rrugë dhe jemi ndeshur me një dru. Edhe pse kisha pësuar tri plagë jeta ime nuk ishte në rrezek. Kemi dalë nga vetura dhe jemi fshehur. Menjëherë me radio-lidhje e kamë lajmëruar stacionin e policisë në Viti dhe Ferizaj. Ndërkohë, në afërsi u ndalën dy vetura nga të cilat dolën disa burra dhe u nisën në djetimin tonë. Unë e nxora revolën dhe i udhërova që të ndalën, ata ishin shqiptarë të cilët thanë «ju ndihmojmë, ju ndihmojmë», por nuk patëm nevojë për ndihmën e tyre, ngase nuk kaloi as pesë minuta arriti patrulla policore e cila na dërgoi në Ferizaj.“

Edhe pse me këtë rast bëhet fjalë për dy pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës, njëri prej tyre kishte edhe gradë të lartë, ky shërbim nuk arriti që t'i zbulojë kryesit e sulmit. Është interesante që pas këtij incidenti në redaksinë e RTK, me anë të postës elektronike ka arritur deklarata e organizatës sekrete “Garda vullnetare sebe-Tigrat” (Srpska dobrovoljačka garda – Tigrovi), që kinse ata e marrin përgjegjësinë për këtë sulm. Vet viktima e sulmit Dejan Jankoviç e ka demantuar këtë duke thënë se deklaratën as që e ka shkruar një serb, sepse ka shumë gabime gramatikore, dhe kjo është dërguar vetëm me qëllim për ta ndryshuar drejtimin e hetimit.

4.5. Sulmi i kryer ndaj çiftit bashkëshortor serb në Çerkolez/Crkoljez, komuna Istog/Istok

Fshati Çerkolez i takon komunës së Istogut/Istog dhe është i banuar me shqiptarë dhe serbë. Në këtë fshat nuk ka bashkëjetesë, nga se është i ndarë në dy pjesë dhe gati nuk ka kontakte ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Serbët shfrytëzojnë rrugën malore, në drejtim të Zubinpotokut/Zubin Potok, sepse ekziston frika për ta shfrytëzuar rrugën magjistrale Pejë-Mitrovicë/Pec- Mitrovica. Pa marrë parasysh në këtë ndarje, nuk ka pasur incidente më të madha ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Më 28 mars 2005 është sulmuar çifti i vjetër bashkëshortor Nedeljko dhe Nevena Vučić, të cilët jetonin të vetmuar në shtëpinë e tyre. Incidenti ndodhi në orët e hershme të mëngjesit. Fqinjët e parë, serbë, rreth orës 7,30 kanë dëgjuar bërtimën e çiftin bashkëshortor. Kur arritën në shtëpinë e tyre kanë vërejtur se ata të dy janë të lënduar rëndë. Fqinja e tyre Zorica Tijanić për FDH deklaroi:

„Dje në mëngjes rreth orës 07.30, dola nga shtëpia, siç veprojmë çdo ditë. Në një moment dëgjova bërtimë nga drejtimi i shtëpisë së Nedelkut. Së pari dëgjova zërin e Nevenkës e pastaj të Nedelkut. Isha e frikësuar dhe shkova te shtëpia e kumatit tim Gligorije Tianiç, i thash se diçka u ka ndoshur Vuçiqve. Unë u nisa e para në drejtim të shtëpisë së tyre. Kur arrita te proni, e vërejta Nevenkën se si me dorë më jepte shenjë që të afrohem. Ishte duke qëndruar në këmbë dhe menjëherë vrapova në drejtim të tyre. Kur u afrova e gjeta Nedelkun në pozitë të ulur, ndërsa Nevenka ishte afër tij. Nedelku tha se e ka parë një burrë i cili e ka sulmuar, por nuk e ka njohur. Nevenka tha që ska parë njëri, por pas goditjes e ka humbur vetëdijen. Në hyrje të garazhës kishte shumë gjak.“



Shenjat e gjakut në garazhën e familjës Vuçiq

Në bisedë me mjekun lokal Maria Stankoviq kemi kuptuar që ata të dy kanë pësuar plagë në kokë, dhe në kafazin e krahërorit. Nedelku kishte disa brirë të thyer. Nevenka ka pësuar plagë në shpatullën djathtë dhe gjoks. *Ne arritëm që ta ndrprejmë gjakderdhjen dhe plagët t'i lokalizojmë. Nedelku kishte më shumë plagë se sa Nevenka. Atij veshi i majtë i është gati i prerë, ndërsa plaga shtrihej përfundi veshi. Nedelku kishte ende plagë, por nga gjaku nuk u vërenin.*

Këtë rast organet hetuese nuk e kanë zbuluar. Ky është, gjithashtu shkak që serbët e tjerë që jetojnë në këtë fshat e ndijenë veten të pasigurtë dhe të pambrojtur.

4.6. Vrasaja e Smail Sukuricës, bošnjak nga fshati Dobrushë/Dobruše, komuna e Istogut/ Istok

Fshati Dobrushë i takon komunës së Istogut/Istok dhe është i banuar me shqiptarë dhe boshnjak. Sipas fjalëve të pjesëtarëve të të dy komuniteteve marrëdhëniet e tyre ndërnacionale ishin në nivel të lakmueshëm. Ekziston një numër i madh i boshnjakëve që nga fshati janë shpërngulur për në BH, por të tjerët kanë mbetur në fshat dhe janë marrë me bujqësi. Një prej tyre është i ndjeri Smail Sukurica, i cili merej me blektori. Sipas fjalëve të vëllait të tij Smaili ka pasur marrëdhënie të mira me shqiptarët lokal. Shqiptarët rregullisht blenin prej tij qumësht dhe prodhime të qumështit. Më datë 13 maj 2005 Smaili e ka lëshuar bagëtinë për të kullotur një kilometër larg shtëpisë. Atë ditë u vra egërsisht nga ana e një personi të panjohur, ose personave të panjohur. Trupi i tij u zbulua në orët e vona të mbrëmjes. Vëllai i tij Sulejman Sukurica për FDH ngjarjen e përshkruan kështu:

„Smali rreth orës 14.00 këtë ditë e dërgoi bagëtinë për të kullotur. Ne kemi një livadh afër pyellit, i cili është gjithashtu i yni, por livadhi nuk mund të shihet nga shtëpia jonë. Përndryshe Samili zakonisht në këtë kohë e qon bagëtinë në kullosa. Rreth orës 17.00 lopët u kthyen vet në stallë. Atëherë nëna filloi që të brengoset. Vëllau ynë Aliu shkoi me një të afërm për ta kërkuar, por nuk e gjetën. Filluan për ta kërkuar në pyell dhe e gjetën nën një dru, opingat i kishin ra disa metra më larg, ndërsa pantollonat e zhveshura deri në gjunjë. Kjo me siguri për shkak të asaj që ata që e kanë kryer krimin e pastaj e kanë tëqhequr. Ndoshta është i vrarë në livadh e pastaj e kanë lënë në pyell. Nuk është vrarë me armë. Ishte gulfatur me një qese najlloni. Gjithashtu, në pjesën e djathtë të kokës kishte lëndime. Atëherë e kanë lajmëruar policinë . Më kanë thënë që ka pasur shumë patrulla policore , të cilat kanë kryer hetimet në vendin e ngjarjes deri në mengjes.“

Lidhur me këtë krim kanë raportuar medijat, ndërsa kanë reaguar edhe institucionet lokale. Familjën Sukurica e kanë vizituar zyrëtarët e komunës së Istogut dhe kanë premtuar se do të bëjnë gjithçka që është e mundur për t'i zbuluar kryesit e kësaj vrasjeje. Kjo nuk është realizuar deri më tani. Sa i përket motivit të vrasjes , as anëtarët e familjës Sukurica nuk janë të sigurtë për motivin e vrasjes së tij.

4.7. Dy sulme ndaj dy djemëshave hashkalinjë në Ferizaj/Uroševac

Në Ferizaj/Uroševac pjesëtarët e komuniteteve RAE jetojnë në disa vendbanime, Lagjet më të mëdha ku jetojnë romët, hashkalinjët dhe egjiptasit janë lagja e Sallahanës dhe rruga e „Halit Ibishti“. Nga përdundimi i luftës kishte incidente në këto dy lagje, por gjatë viteve 2003 dhe 2004 numri i incidenteve është zvogluar. Lirija e lëvizjes për pjesëtarët e RAE ishte përmirësuar si edhe marrëdhëniet me shqiptarët. Problemi më i madh për RAE kishte mbetur gjendja e vështirë ekonomike, përkatësisht papunësia. Mu për këtë një numër i madh i të rinjëve të komunitetit RAE filluan që të mbledhin kanaçe nëpër qytet, në mënyrë që t'i shesin dhe të fitojnë për ushqim. Në mesin e këtyre djelmoshave ishin edhe Faton Ajeti(25) dhe Minur Latifi (14). Minur Latifi jeton në rrugën Halit Ibishti, ndërsa Faton Ajeti në lagjen e Sallahanës.

Më 14 maj 2005 Minuri doli në qytet, me karrocë dore për të mbledhur hekur të vjetër, të cilin pastaj do ta shiste. Në rrugë për në shtëpi rreth orës 12,30 një djalosh shqiptar i doli në pritë. Ai ishte 15 ose 16 vjeç dhe filloi që ta maltretojë Minurin, por kur ky bëri përpjekje për tu larguar, u sulmua me thikë në krah. Policia është informuar lidhur me këtë incident, si dhe me kryesin e kësaj vepre, ndërsa në vazhdim është procedura gjyqësore. Minuri është në shërim shtpiak, me qenë se familja nuk ka mjete materiale për shërimin e tij. Kjo familje është nëntëanëtarëshe dhe jeton nga asistenca sociale.

E njejta ndodhi edhe me Faton Ajetin, vetëm tri ditë më vonë. Ai dhe shoku u tij Blerim Emini, gjithashtu hashkali, dolën për të mbledhur kanaçe të zbrazura në periferi të qytetit. Në rrugë për në shtëpi i pritën disa të rinjë shqiptarë. Për FDH viktima Faton Ajeti incidentin e përshkruan me këto fjalë:

„Më 17 maj 2005 së bashku me shokun tim Blerim Emini, gjithashtu hashkali nga Ferizaji/Uroševac dolëm për të mbledhur kanaçe të zbrazta në lum. Ky vend gjendet në dalje të Ferizajit/Uroševac. Mblodhëm gati dy thasë me kanaçe të zbrazta dhe u nisëm për në shtëpi. Rreth orës 17,30 ishim në rrugën Besim Rexhepi. Atëherë kemi vërejtur pesë të rinjë që na kishin dalë në pritë. Ishin të rinjë, rreth 18 vjeç, nuk i njihja. Kur u takuam pa fjalë filluan të na rahnin. Ne i braktisëm thasët me kanaçe dhe filluam të ikim nëpërmes një livadhi. Ata vraponin pas nesh dhe na zunë diku kah mesi i livadhit. Derisa na rahnin unë u përpoqa që të iki. Një prej tyre ishte zeshkan dhe e nxorri thikën, pastaj edhe tjetri e nxorri thikën e vet. Ky që ishte zeshkan më goditi mua me thikë në shpatullën e majtë, ndërsa tjetri në kofshë. Unë u rrëzova dhe ata me siguri menduan se më kanë vrapuar, prandaj u ndalën. Unë e shfrytëzoja rastin dhe fillova përsëri të vrapoj. Blerimin nuk e therrën me thikë, por e rahnën. Sapo e vërejtën që po iki përsëri u nisën pas meje. Blerim Emini filloi të ikte në anën e kundërt. Unë vrapoja shumë shpejtë dhe gjithë kohën kisha shumë gjakderje. Ata më përcollën deri në mahallën time, Sallahanë Unë arrita deri tek dera e shtëpisë sime, kur më pa fqiu im, kisha humbur shumë gjakë dhe e humba vetëdijen. Pastaj nuk më kujtohet asgjë. E di që më kanë dërguar në spitalin e Ferizajit e pastaj edhe Prishtinës. Tani jam pak më mirë, por edhe më tutje nuk mund të eci normalisht, zakonisht këtu rri i shtrirë dhe pushoj..“

Policia i ka të njohur kryesit e këtij sulmi dhe procedura është në vazhdim. Hetuesit e FDH e kanë vizituar Zyren për komunitete pranë Kuvendit Komunal në Ferizaj dhe zhvilluan bisedë me përfaqësuesin e komunitetit RAE. Ai për FDH deklaroi:

„Këto incidente kanë ndikuar jashtzakonisht keq në pjestarët e komunitetit RAE. Tensionet janë ritur, ndërsa njerëzit kanë filluar që të brengosen për sigurinë e tyre. Unë personalisht mendoj që këto incidente nuk janë të organizuar. Ne e kemi përkrahjen e Kuvendit Komunal Ferizaj, si dhe të institucioneve të tjera.“

4.8. Të shtëna mbi shtëpinë e një pjesëtari të komunitetit hashkalinjë në fshatin Allas/Alas, komuna e Lipjanit Lipljan

Dy vitet e para pas përfundimit të konfliktit të armatosur në Kosovë, pjesëtarët e komunitetit hashkalinjë shpesh herë ishin në shënjestër të shqiptarëve dhe kishte incidente. Megjithatë, nga viti 2002 situata ka ndryshuar. Pjestarët e komunitetit hashkalinjë filluan që të lëvizin lirë, të kanë çasje të lirë në institucionet e sistemit dhe në përgjithsi jeta ka filluar të normalizohet. Si shembull i mirë është komuna e Lipjanit/Lipljan me fshatra, por incidentet nuk u ndalën në përgjithësi. Më 17 shtator 2005, në orët e vona është shtënë nga armët automatike mbi shtëpinë e një pjesëtari të komunitetit hashkalinj. Për fat të mirë nuk kishte të lënduar, por kjo ka ndikuar që hashkalinjë të këtij fshati të ndihen të pasigurtë. Në vazhdim shkëpusim një pjesë të deklaratës të kryefamiljarit të shtëpisë që ia dha FDH.

„Rreth orës 21.00 persona të panjohur papritmas kanë shtënë me armë zjarri mbi shtëpinë time. Nga frika të gjithë jemi shtrirë mbi dysheme. Të shtënat vinin nga drejtimi i shtëpisë së afërt, pronar i së cilës është shqiptarë. Askush nuk ka parë kush ka shtënë, por shtëpia ime është pak e dëmtuar, me xhama të thyer në dritare, ndërsa në mure kanë mbetur shenjat e plumbave. Kjo nuk është asgjë sepse kemi mundur të vritemi. Pjestarët e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) kanë reagur menjëherë dhe erdhën në vendin e ngjarjes. Gjithashtu erdhi edhe patrulla e KFOR-it. Në afërsi të shtëpisë sime kemi gjetur 60 gëzhjoja të plumbave të shkrepur nga armët automatike. Deri më tani SHPK nuk e ka zbuluar personin, ose personat të cilët pa arsye kanë shtënë mbi shtëpinë time. Ata pohojnë që hetimet janë në vazhdim. Nuk e di kush dhe me çfarë qëllimi ka shtënë. Unë deri më tani nuk i kam bërë askujt keq. Çdo ditë kam shkuar në punë nga shtëpia ime në fshatin Allas/Mali Alas deri te ndërtesa e komunës në Lipjan, ku gjendet zyra ime dhe kurrë nuk kam pasur probleme. Unë nuk besoj që sulmi mbi shtëpinë time ka ndonjë prapavi politike, sepse po të ishte ashtu, ata do të më kishin sulmuar edhe më herët. Mendoj që në pyetje janë kriminel të zakonshëm. Ndoshta e kanë bërë këtë individ nga fshati për shkak të xhelozisë, sepse unë kam shtëpi të bukur, pasuri, jam i punësuar, fëmijët shkojnë në shkollë ... Me një fjalë familja ime ka kushte të mira për jetë. Unë nuk shoh arsye tjetër për këtë sulm. Do të shohim, ndoshta policia do të zbulojë diçka

4.9. Dy sulme me mjete shpërthyes mbi shtëpitë e shqiptarëve në pjesën veriore të Mitrovicës

Jeta e komuniteti shqiptarë, e cila është pakicë në pjesën veriore të Mitrovicës është gjithashtu e vështirë sikurse për pakicat etnike që jetojnë në pjesët tjera të Kosovës. Situata më e rëndë ka qenë pas konfliktit të armatosur në vitin 1999. Me kohë situata ka ndryshuar. Shqiptarët nga pjesa veriore e Mitrovicës/Mitrovica kanë qarkulluar me veturat e tyre deri në pjesën jugore. Ata nuk janë të integruar në institucione që veprojnë në pjesën veriore të Mitrovicës, thjeshtë ata vetëm jetojnë në pjesën veriore të qytetit, të gjitha të tjerat i zgjedhin në pjesën tjetër të qytetit, duke filluar nga blerja, shërimi, shkollimi e të tjera. Sipas fjalëve të shqiptarëve lokal mardhëniet ndërnjerzore me fqinjët e tyre serbë janë në nivel. I ndihmojnë njëri-tjetrit shoqërohen dhe nuk kanë probleme. Ata pohojnë se në shënjestër janë njerëzit tjerë, të cilët përndryshe nuk janë nga Mitrovica, por momentalisht jetojnë aty. Ekzistojnë dy lagje në pjesën veriore të qytetit ku jetojnë shqiptarët: mahalla e boshnjakëve, e cila me një urë lidhet me pjesën veriore të qytetit të ashtuquajturën Mikronaselje, e cila gjendet në pjesën e epërme të qytetit. Më 11 mars 2005 është hedhur mjeti shpërthyes mbi shtëpinë e familjes Beka. Me këtë rast askush nuk është lënduar, vetëm është shkaktuar dëmi material. Dëshmitari Sadri Beka e përshkruan këtë ngjarje për FDH me këto fjalë:

„Atë natë isha në shtëpi. Ishte pesë minuta pas mesnate kur kemi dëgjuar eksplozimin. Dolëm nga shtëpia dhe shkuam te gruaja e axhës tim Zimretja. E kemi parë se është hedhur një mjet shpërthyes dhe e kemi lajmëruar policinë, e cila arriti pas 10 minutash. Mjeti shpërthyes është hedhur mu para derës së hyrjes në shtëpi. Dera ishte e thyer, si dhe dritarja e shtëpisë, por nuk kishte zjarrë. Pas policisë kanë ardhur edhe pjestarët e KFOR-it belg. Na kanë pyetur kush ka mundur ta bëjë këtë. Natyrisht, ne nuk mund ta dijmë. Unë supozoj se ky është një nga përpjekjet për të na friksuar dhe t'i braktisim shtëpitë tona. Përndryshe unë jam i sigurt që këtë nuk e kanë bërë fqinjët tanë serbë, por me siguri kanë qenë njerëz të tjerë.“

Si edhe në shumicën e rasteve hetimi i policisë lidhur me këtë incident nuk ka përfunduar dhe kryesit e kësaj vepre nuk janë zbuluar. Situatë e njejtë është edhe me incidentin e dytë, i cili ka ndodhur në rrugën Mesha Selimoviq, me ç'rast është hedhur mjeti shpërthyes mbi shtëpinë shqiptare. Kjo ka ndodhur vetëm një ditë pas incidentit që ndodhi në Mikronaselje. Në këtë pjesë të qytetit, në afërsi të mahallës së boshnjakëve jetojnë tri familje shqiptare, të gjithë me mbiemërin Peci. Të gjitha shtëpitë tjera janë shtëpi serbe. Më 18 mars 2005, në orët e vona, në oborin e tyre të perbashkët është hedhur një mjet shpërthyes, nga eksplozimi i të cilit janë thyer dritaret dhe dyert. Dafina Peci për FDH incidentin e përshkruan në vijim:

„Natën ndërmjet 12 dhe 13 marsit të këtij viti isha në shtëpi me nënën dhe babain tim si dhe vëllai im i madh. Shikonim TV. Unë dhe vëllai im ishim të ulur në kauç, me shpinë të kthyer nga dritarja, e cila ka shikimin në oborr. Përndryshe pranë oborrit tonë gjendet shtëpia e axhës Hetem. Ishte saktësisht 12.10 kur e dëgjuam eksplozimin e fortë. Të gjitha xhamat në dritare janë thyer dhe më binin në shpinë. Për çudi se si nuk jemi

lënduar. Unë e humba vetëdijen. Kur u qetësuam pak në oborr erdhën disa fqinjë tanë serb. Ata shprehën keqardhje për shkak të këtij incidenti madje një grua e moshuar qante. Ata e lajmruan policinë e cila erdhi shumë shpejt. Ishin pjestarë të SHPK-së, serbë nga pjesa veriore e qyetit, më pas erdhën edhe pjestarët e KFOR-it. Ne ende nuk jemi në dijeni për çfarë mjeti shpërthyes bëhet fjalë. Përndryshe, ai është hedhur menjëherë pranë murit të shtëpisë së xhaxhait tim Hetem Peci, por më shumë dëme janë shkaktuar në shtëpinë tonë. Në shtëpinë e tij është thyer një dritare dhe një derë si dhe një pjesë e vogël e çatisë. Në pjesën e betonit pranë murit është krijuar një gropë nga detonimi. Shtëpia jonë nga muri i shtëpisë së Hetemit është larg 4-5 matra, ngase oborri ynë është i vogël. Prandaj në shtëpinë tonë janë thyer të gjitha dritaret, dera e hyrjes, si dhe një pjesë e kulmit të shtëpise tonë.“

Për të dy rastet shqiptarët janë të sigurt që sulmet nuk i kanë kryer fqinjët e tyre serbë. Ata konsiderojnë që motivi i këtyre sulmeve është frëksimi, për ti braktisur shtëpitë e tyre në pjesën veriore të Mitroviës.“

4.10. Shtëpia serbe e minuar në fshatin Kllokot/Klokot, komuna e Vitisë/Vitina

Fshati Kllokot/Klokot i takon komunës së Vitisë/Vitina dhe para konfliktit të armatosur ka qenë fshat i pastër serb. Shumica e vendasëve të këtij fshati kur nuk ka braktisur shtëpitë e tyre, por meqë pas konfliktit të armatosur kishte sulme, disa prej tyre i kanë shitur pronat dhe janë shpërngulur nga fshati. Tre serbë nga ky fshat janë kidnapuar në korrik të vitit 1999 dhe trupat e tyre janë zbuluar disa ditë më vonë. Një grua nga ky fshat në tetor 2002, derisa punonte në arën e vet shkeli mbi minë dhe ka vdekur në vend. Gjatë vitit 2003 dhe 2004 numri i sulmeve mbi serbët lokal ka rënë, gjë që ka ndikuar edhe në lirinë e lëvizjes. Serbët lokal kanë qarkulluar me automjete deri në Viti, Gjilan dhe në tërë rajonin e Gjilanit. Megjithatë në vitin 2005 ka ndodhur një incident kur është minuar shtëpia e Milan Marinkoviqit. Më 10 maj 2005 në orët e vona të mbrëmjes ka eksploduar një mjet shpërthyes, me ç'rast është rënuar në tërësi shtëpia e Millanit. Për fat, në atë moment askush nuk ishte në shtëpi, kështu që nuk pati viktima në njerëz. Millan Marinkoviq për FDH ngjarjen e përshkruan me këto fjalë.

„Rreth orës 03.15 në mengjes kam dëgjuar eksplodim të fqushëm. Kam menduar që ushtarët e KFOR-it zhvillojnë ushtrime ushtarake, prandaj nuk u ngrita nga krevati. Në mengjes u zgjova si zakonisht në orën 6.15, dola në oborr dhe pastrova fytyrën tek bunari. Atëhere bashkëshortja ime më pyeti nëse kam qenë në mengjes tek shtëpia e tyre e re. Unë i thash që jo, ndersa ajo më tha se shtëpia jonë është e rrënuar. Menjëherë shkova atje, por s'kisha çfarë të shoh. E gjithë shtëpia është rënuar me një potez. Si duket se janë minuar shtyllat të cilat e mbanin anën e përparme të shtëpisë, ngase është rënuar edhe kulmi. Shtëpia është rënuar sikurse të ishte nga kartoni. I biri im e lajmëroi policinë, ata erdhen rreth orës 7.00. Çdo minutë arrinte nga një patrullë policore, kështu që kishte shumë policë, si dhe pjestarë të KFOR-it. Policia më ka pyetur a dyshoj në dikë, unë askend nuk e kisha parë dhe nuk mund ta fajësoj askend, derisa po qëndronte policija erdhi fqiu im shqiptar, i cili ka blerë shtëpinë afër shtëpisë sime. Unë e pyeta:., komshi a

është kjo mirë“ ai më shikoi dhe u përgjigj:“ kjo nuk është mirë komshi, por zoti i sheh të gjitha“ natyrisht unë nuk dyshoj në fqinjët, pa marë parasysh që ata sapo kanë ardhur. Këtë dikush e ka bërë me qëllim për të na frikësuar dhe ta braktisim fshatin.

Hetimi zyrtar kurrë nuk ka përfunduar, ndërsa familja Marinković ka mbetur pa kulm mbi kokë.



Milan Marinković mbi rrënojat e shtëpisë

4.11. Janë hedhur dy bomba mbi shtëpinë e një të kthyerit të komunitetit serb të kthyer në Klinë/Kljina

Në bazë të hetimeve lidhur me kthimin e personave të zhvendosur, Fondi për të drejtën humanitare ka konkluduar që kthimi në mënyrë më të mirë është organizuar në qytetin e Klinës/Kljina. Në shkurt të vitit 2005 në Klinë është kthyer familja e parë serbe në shtëpi të tyre me ndihmën e DRC (Danish Refugee Council). Mirëpo, kthimin e tyre shumë e kanë ndihmuar edhe organet lokale komunale të Klinës. Në Prill është kthyer edhe familja tjetër e cila jeton në ndërtesë. Deri më tash janë kthyer 19 familje serbe. Ajo që dallon kthimin e serbëve në Klinë/Kljina nga situatat në vende tjera është se ata janë kthyer në lagje të ndryshme, nuk kanë përcjellje dhe lëvizin lirë nëpër qytet. Kanë qasje në të gjitha institucionet komunale dhe qytetarët e nacionalitetit shqiptarë i kanë pranuar ata mirë. Megjithatë, ka ndodhur një incident, i cili për fat të mirë nuk ka pas sukses që serbët t'i zbrapsë nga kthimi.

Në natën ndërmjet 16 dhe 17 qershorit 2005 para dyerve të shtëpisë së familjës Toshiq janë hedhur dy bomba. Familja Toshiq është kthyer në Klinë në fillim të qershorit. Ata kanë shtëpinë në një lagje periferike. Në momentin e incidentit, në shtëpi ka qenë vetëm çifti i vjetër bashkëshortor Tishiq. Incidentin për FDH i biri i tyre Punisha e ka përshkruar me këto fjalë:

„Në natën ndërmjet 16 dhe 17 qershori, rreth orës 1,00 pasmesnate, dikush ka hedhur dy bomba në oborrin tonë. Njëra prej tyre ka rënë pranë derës së hyrjes, kurse tjetra më largë, në kënd të shtëpisë. Sipas fjalëve të prindërve të mi, ata kanë dëgjuar dy shpërthime të fuqishme. Dritarja në dhomën e tyre është thyer dhe xhami ka ra nëpër shtrat, por për fat ata dy nuk janë lënduar. Kanë qenë mjaft të frikësuar, dhe një kohë mjaftë të gjatë nuk kanë guxuar të lëvizin nga vendi dhe as dritën ta ndezin. As fqinjët shqiptarë nuk kanë ardhur për të shikuar se çka ka ndodhur. Pas 10-15 minutash ka ardhë automjeti i parë i policisë, e më pastaj edhe shumë automjete të policisë, si dhe automjetet e KFOR-it. Policia e ka kryer punën e vet, aty, qëndruan tërë natën edhe të nesërmën paradite. E kanë incizuar vendin e incidentit. Prindërit e mij kanë dhënë deklaratën, por kur i kanë pyetur; në kë dyshojnë, natyrisht që ata nuk kanë mundur të thonë asgjë. Gjithashtu, i kanë pyetur a dëshirojnë që t'i vendosin në ndonjë vend tjetër. Prindërit e mij kanë thënë se ata janë kthyer për të jetuar në shtëpinë e tyre, e jo përsëri ta lëshojnë atë.

Ky ishte incidenti i parë që ndodhi nga fillimi i kthimit të serbëve në Klinë. Të gjithë të kthyerit kanë qenë të frikësuar, por askush nuk e ka lëshuar Klinën. Për një vendim të tillë ka ndihmuar-ndikuar edhe hetimi policor. Tre persona janë ndaluar si të dyshuar për këtë akt. Edhe pas kësaj ngjarjeje procesi i kthimit nuk është ndaluar, përkundrazi edhe familje të tjera kanë vendosur të kthehen në shtëpitë e tyre.

4.12. Të shtëna ndaj një të riu serb në fshatin Sushicë/ Sušica tek Gračanica/ Gračanica

Incidenti i fundit, në një varg incidentesh të drejtuara kundër komunitetit pakicë serb, janë të shtënat ndaj një të riu serb në fshatin Sushicë tek Gračanica. Fshati Sushicë gjendet 3-4 kilometra nga Gračanica dhe është një fshat i etnikisht i pastër. Ndërkaq, rruga e cila kalon përmes këtij fshati i lidhë disa fshatra, ndër të cilat është Kishnica/Kišnica, Janjeva/Janjevo, Gushterica e Epërme dhe e Poshtme/ Donja i Gornja Gušterica, Saskoc/Saskovac dhe Teqja/Teća. Në disa nga këto fshatra jetojnë edhe banorë shqiptarë, dhe ata shpesh e shfrytëzojnë rrugën përmes Sushicës/Sušice për të ardhur në Prishtinë. Më 30 nëntor, rreth orës 13,20, derisa po kthehej nga shkolla, ndaj të riut Dragan Jovanoviqit është shtënë nga një automobil në lëvizje. Dragani ka pësuar plagë tejshpuese në pjesën e epërme të dorës së djathtë. Dragan Jovanoviqi, për FDH ngjarjen e përshkruan me këto fjalë:

„Në atë moment nuk e kam parë asnjë kalimtar në rrugë. Kam vërejtur një autoveturë që vinte në drejtimin tim. Kam vërejtur se autovetura ishte e tipit të Audi-a4 ngjyrë të kuqe të mbylltë. Në te ishin dy njerëz. Sa më kujtohet, autovetura kishte targa kosovare(KS). Lëvizte shumë ngadale. Unë nuk e kam përqënduar vëmendjen në atë veturë. Ecja anës së majtë të rrugës dhe njëherësh provoja që një shoku tim t'i dërgoj mesazh telefonik. Autovetura ecëte shumë ngadale. Në momentin kur jemi barazuar me veturën kamë vërejtur se dritarja në anën e vozitësit të saj kundruell meje ishte e hapur. Nuk kam dëgjuar nëse ata njerëzkanë folur, e as dëgjuar muzikë ose çkado tjetër. Nuk i kam shikuar ata dy. Prandaj edhe nuk di fare se si duken dhe çfarë moshe janë. Unë kam vazhduar të shkruaj mesazh telefonik. Saktësisht në momentin kur jemi gjendur krahas tyre unë kam ndjerë një dhëmbje të fortë mbi bryl në dorën e djathtë. Nuk kam dëgjuar kurfar të shtëne. E di që kam ra për tokë, pastaj jamë ngritur dhe kam filluar të vrapoj

përmes arës sa më largë rruge. Nuk di sa kam vrapuar larg, por më kujtohet se në një çast e kam kthyer kokën të shikoj se çfarë po ndodhë. Kam vërejtur automobilin i cili po vazhdonte me të njejtën shpejtësi (të vogël) në drejtim të Graçanicës.

Viktimën e kësaj ngjarjeje familja e ka dërguar në Graçanicë për shërim, kurse policia ka ardhur në vendin e ngjarjes dhe e ka bërë shikimin. Mirëpo, ende edhe sot e kësaj dite askush nuk është ndaluar për këtë ngjarje. Ky incident ka shkaktuar paknaqësi dhe indinjatë tek serbët e vendit. Mëngjesin e ardhshëm një grup të rinjesh serbë ka gjuajtur me gurë mbi disa vetura të shqiptarëve në rrugë kryesore, e cila kalon përmes Graçanicës.

Pa marrë parasysh në të gjitha këto incidente organet kompetente për siguri në Kosovë, KFOR-i, UNMIK-u dhe SHPK konfirmojnë se situata e sigurisë është stabile. Shkalla shumë e ulët e ndriqimit të këtyre rasteve ka ndikuar tek komunitetet pakicë që edhe më tutje të ekzistojë frikë. Kjo gjë, drejtë për drejtë ka ndikuar edhe në lëvizjen e lirë dhe në kthim.

5. Gjykimet lidhur me ngjarjet e marsit në Kosovë

Në kuadër të projektit të përcjellës së gjykimeve për krime të luftës dhe vrasjet e motivuara në baza etnike dhe politike, zyra për FDH gjatë vitit 2005 ka përcjellur një numër të gjykimeve lidhur me ngjarjet e marsit të vitit 2005.

Zgjedhja e gjykimeve është bërë në bazë të peshës së veprave penale, për të cilat ngarkohen të akuzuarit. Gjykimet lidhur me ngjarjet e marsit, që i ka përcjellur zyra janë mbajtur para kolegjeve ndërkombëtare ose të përziera të Gjykatave të Qarkut të Kosovës. Kryesuesit e kolegjeve, në këto raste, ishin gjyqtarët ndërkombëtarë.

Gjatë vitit 2005 janë përcjellur:

- pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane, gjykimi i Sadri Shabanit,
- pranë Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane, gjykimi i Xhevdet Sylejmanit
- pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë- gjykimi i Mehmet Morinës.

Gjithashtu, Zyra në dhjetor 2004 ka përcjellur gjykimin e Jeton Zogaj pranë Gjykatës së qarkut në Prizren.

Numri i gjykimeve lidhur me ngjarjet e marsit, të cilat i ka përcjellur FDH ka qenë i kufizuar me obligimet e projektit për përcjelljen e gjykimeve për krime lufte.

Sipas të dhënave të OSBE-s, në trazirat e marsit kanë marrë pjesë 51.000 pjesëmarrës në 33 trazira. Sipas OSBE-s, deri më 18. nëntor 2005 për pjesëmarrje në trazira janë akuzuar 426 persona, prej të cilëve 316 lëndë janë përfunduar, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 110 lëndë. Për pjesëmarrje në trazirat e marsit dhe vepra penale të kryera në këto trazira janë dënuar gjithësej 209 persona, në 95 raste aktakuzat janë refuzuar dhe 12 raste janë liruar nga aktakuza.

5.1. Gjykimi sipas lëndës „Sadri Shabani e të tjerë“

Gjykimi sipas aktakuzës „Sadri Shabani e të tjerë“ është zhvilluar në Gjykatën e Qarkut në Gjilan/Gnjilane para kolegjit të përzier treanëtarësh, të cilin e kryesoi gjyqtari ndërkombëtar nga Austria Klaudija Finc. Në përbërje ishte edhe një gjyqtarë lokal.

Me aktakuzën e prokurorisë së qarkut në Gjilan/Gnjilane, të cilën e ka përfaqësuar prokurori ndërkombëtar, të akuzuarit: Agron Ibrahim, Nexhat Ramadani, Shaqip Brahimi, Xheladin Salihu, Sadri Shabani dhe Agim Abdullahu, ngarkohen që më 17 mars 2004 kanë nxitur rrezik për jetën dhe trupin e njerëzve në vendin ku kanë qenë të tubuar një numër i madh njerëzish, si dhe kanë rrezikuar pasurinë me përmasa të mëdha.

Me të njëjtën aktakuzë, të akuzuarit: Agron Ibrahim, Nexhat Ramadani, Shaqip Brahimi, Xheladin Salihu ngarkohen se gjatë kohës së trazirave të marsit kanë privuar nga jeta Slobodan Periqin dhe e kanë lënduar rëndë nënën e tij Anka Periq.

I akuzuari Xheladin Salihu ngarkohet për veprën penale “armëmbajtje pa leje” (në periudhën prej 16 mars deri më 26 marsi 2004 ka mbajtur pushkë automatike AK47 të kalibrit 7,62 mm me municion), si dhe veprën penale „pengimi i personave të autorizuar në sigurimin e dëshmitarëve“.

Shqyrtimi kryesor i kësaj lënde filloi më 25 janar 2005 dhe ka pasur 25 vazhdimësi në të cilat janë dëgjuar 30 dëshmitarë, kryesisht pjesëtarë të SHPK, të cilët ditën kritike kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve të marsit ose si persona zyrtarë kanë punuar në këto raste. Gjashtë dëshmitarë kanë pasur status të mbrojtur. Ata janë dëgjuar në gjykatore në prani të publikut, por me këtë rast identiteti i tyre nuk është zbuluar.

Prokurori ndërkombëtar gjatë procedurës e ka ndryshuar aktakuzën, duke i saktësuar veprimet e të akuzuarve në datën e 17 marsit 2004 në Gjilan; Agron Ibrahim, Nexhat Ramadani, Shaqip Brahimi, Sadri Shabani, Xheladin Salihu, në bashkëveprim me të tjerët, kanë kryer veprat penale vrasje dhe nxitje të rrezikut të përgjithshëm.

Sipas aktakuzës së ndryshuar i akuzuari i parë Agron Ibrahim ngarkohet se e ka qëlluar së paku një herë Slobodan Periqin, këmbëve; i akuzuari i dytë Nexhat Ramadani se iu ka vërsulë Slobodan Periqit dhe e ka goditur me shkop së paku një herë kokës dhe duarëve; i akuzuari i tretë

Saqip Brahimi se e ka goditur Sllobodan Periqin një herë me tjegull ose shkop; i akuzuari i katërt Xheladin Salihu se e ka marrë nga vendi i ngjarjës pushkën automatike AK-47, pronë e Sllobodan Periqit Veprimet e akuzuarve sipas aktakuzës kanë sjellur deri tek vdekja e Sllobodan Periqit, shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore Anka Periqit dhe shkatrimin e pronës së tyre, shtëpisë dhe automjetit.

- a) Agron Ibrahimimi ose Nexhat Ramadani e të tjerët kanë rrezikuar pronën e Sllobodan dhe Anka Periqit, duke hedhur gurë mbi shtëpinë e tyre dhe duke tentuar që ta djegin automobilin e tyre.
- b) Agron Ibrahimimi, Nexhat Ramadani, Saqip Brahimi, Xheladin Salihu e të tjerët kanë përcjellur Sllobodan Periqin, ose kanë qenë në afërsi të tij pas sulmit që masa ia ka bërë pronës së tij.
- c) Agron Ibrahimimi e ka goditur Sllobodan Periqin së paku një herë, këmbëve;
- d) Nexhat Ramadani është vërsulur mbi Sllobodan Periqin dhe e ka goditur me shkop së paku një herë, kokës ose duarve;
- e) Saqip Brahimi ka goditur Sllobodan Periqin me tjegull ose shkop;
- f) Xheladin Salihu ka marrë nga vendi i ngjarjës pushkën automatike AK-47, pronë e Sllobodan Periqit, para apo gjatë sulmit.

Me aktgjykim të akuzuarit janë shpallur fajtorë dhe u janë shqiptuar denimet si vijon:

– 16 heqje lirie Nexhat Ramadani;

– 3 vjet e 6 muaj heqje lirie Saqip Brahimin, duke e marrë parasysh edhe denimin e shqiptuar të mëparshëm në kohëzgjatje prej 3 muajsh nga gjykata komunale e Gjilanit/Gnjilane. Aktgjykimi P. nr. 201/04 të datës 2 qershor 2004 lidhur me veprën penale të paraparë me nenin 46 LPPK dhe janë tërhequr dënimet prej 1 vit e 6 muaj të shqiptuara nga ana e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, aktgjykimi P. nr. 21/01 të datës 10 mars 2003 lidhur me veprën penale të paraparë me nenin 45, paragrafi 3 LPPK.

– 11 vjet heqje lirie Xheladin Salihut, duke marrë parasysh veprën penale nga neni 45 LPPK dhe dënimet e shqiptuara më herët me burg në kohëzgjatje prej 3 muajsh nga ana e Gjykatës së Qarkut në Gjilan me arsyetimin P. nr. 12/04 të datës 10. mars 2004.

– 2 vjet e 6 muaj heqje lirie Sadri Shabanit, dhe

– 2 vjet e 6 muaj heqje lirie Agim Abdulahut.

Në denimet e shqiptuara të dënuarve u është llogaritur koha e kaluar në paraburgim.

5.2. Gjykimi sipas lëndës „Xhevdet Sylejmani“

Para kolegjit të përzier të Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane, Zyra e Fondit për të Drejtat Humanitare në Prishtinë ka përcjellur gjykimin e Xhevdet Sylejmanit, të cilin prokurori publik

në Gjilan/Gnjilane e ka akuzuar për nxitjen e rrezikut të përgjithshëm. I akuzuari ngarkohet se me veprimet e 17 marsit 2004 ka kryer vepra penale: nxitja e urrejtjes nacionale, racore dhe fetare, përçarje dhe urrejtje, nxitje e rrezikut të përgjithshme me mjete të rrezikshme, duke shkaktuar dëme të mëdha materiale dëshmitarëve të mbrojtur „SD“ dhe „BD“.

Gjykimi është mbajtur para kolegjit të përzier treanëtarësh, të cilin e ka kryesuar gjyqtari ndërkombëtar dhe me pjesëmarrje të dy gjyqëtarëve porotë. Aktakuzën e ka përfaqësuar prokurori ndërkombëtar. Senaca kryesore ka pasur 17 vazhdime gjykimi, në të cilat krahas të akuzuarit janë dëgjuar edhe të dëmtuarit dhe dëshmitarët. Një numër i madh dëshmitarësh është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve të mbrojtur. Seanca kryesore, me rastin e dëgjimit e dëshmitarëve të mbrojtur ka qenë e mbyllur për publikun. Dëgjimi i dëshmitarëve të mbrojtur është bërë me ndihmën e përkthyesit, kurse të pranishmit në gjykatore nuk kanë mundur ta dëgjojnë zërin e tyre.

Me aktgjykimin K. nr. 158/2004 të datës 31. tetor 2005. Xhevdet Sylejmani është shpallur fajtor dhe dënuar me kusht me heqje lirie në kohëzgjatje prej 2 vjetësh, cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 vjetësh nga aktgjykimi i plotëfuqishëm, i përmenduri nuk kryen vepër të re penale.

5.3. Gjykimi sipas lëndës „Mehmet Morina“

Gjykimi sipas lëndës „Mehmet Morina“ është mbajtur para kolegjit ndërkombëtar të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, kurse aktakuzën e ka përfaqësuar prokurori ndërkombëtar.

I akuzuari Mehmet Morina së pari nga ana e prokurorit ndërkombëtar është akuzuar për veprat penale në vijim:

1. Vrasja nga neni 30. paragrafi. 2. pika 2. LPJ, e lidhur me nenin 22. LPJ (neni 147. pika 6. lidhur me nenin 23. LPPK);
2. Pjesëmarrja në masë e cila kryen vepra penale, që është e sanksionuar me nenin 200. paragrafi. 1. LPJ (neni 320. LPPK).

Gjyqtari për konfirmim të aktakuzës nuk e ka pranuar akuzën për vrasje, duke e ndryshuar atë me akuzat:

1. Tentim vrasjeje në mënyrë brutale dhe të dhunshme, siç është paraparë me nenin 30. paragrafi. 2. pika 1, 3. dhe 5. LPJ, e lidhur me nenin 19. LPJ (neni 147. pika 3, 5, 6. e lidhur me nenin 20. LPPK).
2. Lëndim i lehtë trupor, i shkaktuar me mjet të rrezikshëm nga neni 39. paragrafi. 2. LPJ (neni 153. paragrafi. 2. LPPK).

Me rastin e konfirmimit të aktakuzës është refuzuar edhe akuza e prokurorit ndërkombëtar për veprë penale të pjesëmarrjës në grupin, i cili kryen vepra penale nga neni 200 paragrafi.1. LPJ (neni 320. LPPK).

Senaca kryesore lidhur me këtë lëndë ka filluar më 13 prill 2005. Ka zgjatur mbi 3 muaj, ka pasur tetë vazhdime, në të cilat, përveç të akuzuarit janë dëgjuar edhe të dëmtuarit si dhe personat e autorizuar zyrtarë, të cilët kanë marrë pjesë në fazat e ndyshme të zgjidhjes së procedurës.

Gjatë procedurës ka pasur nëntë dëshmitarë, prej të cilëve gjashtë dëshmitarë të akuzës, ndër të cilët njëri ka qenë i mbrojtur.

Dëshmitari i mbrojtur është dëgjuar në seancën e mbyllur për publikun, gjatë kohës së dëshmimit ka qëndruar në dhomë të posaçme. Në dëshminë e tij të dhënë në seancën kryesore, është përshkruar detajisht mënyra e kryerjes së veprës penale, e cila të akuzuarit i ngarkohet (se nga një largësi jo të madhe ka parë të akuzuarin se si e qëllonte me shufër metali viktimën në pjesën e përparme të kokës dhe se goditja ka qenë sikurse “ e ramja e sopatës”.

Gjatë seancës është kryer edhe shikimi në vendin e ngjarjes, në të cilin kanë prezantuar edhe dëshmitari i mbrojtur, i cili i ka treguar edhe vendet në të cilat ditën e kryerjes së veprës penale ka parë të akuzuarin dhe ka përshkruar mënyrën se si e ka goditur viktimën. Organizimi i shikimit është bërë ashtu që i akuzuari që ka prezantuar shikimin e vendit nuk ka mundur ta shoh dëshmitarin.

Me aktgjykim K.nr. 439/2004 të datës 22. korrik 2005 Mehmet Morina është shpallur fajtor për veprë penale tentim vrasjeje nga neni 30. parag. pika 1. dhe 5. LPJ lidhur me nenin 22. LPJ (neni 147 pika 5 dhe 6 LPPK e lidhur me parag. 2 dhe 23. të të njëjtit Ligj) për të cilat iu është shqiptuar dënimi me 18 vjet heqje lirie – për shkak të tentim vrasjes të Zlatibor Trajkoviqit në bashkëveprim me të tjerët më datën 17. mars 2004. Në dënimin e shqiptuar është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19 prill 2004.

Trupi i viktimës, Zlatibor Trajkoviqit, gjatë trazirave është djegur. Kolegji gjyqësor nuk ka pasur dëshmi se lëndimi i shkaktuar nga ana e akuzuarit ka qenë shkaktarë direkt i vdekjes së të ndjerit Trajkoviq.

5.4. Gjykimi sipas lëndës”Jeton Zogaj e tjerët“

Sipas lëndës penale „Jeton Zogaj dhe të tjerët” (Artan Bytyqi dhe Gazmend Xhoxhaj) më 14.dhjetor 2004. është mbajtur seanca kryesore me rastin e aktakuzës së prokurorit publik të qarkut në Prizren/Prizren, sipas të cilës i akuzuari ngarkohet për kryerje të shumë veprave penale: nxitja urrejtjes nacionale, racore dhe fetare, përçarje dhe urrejtje, shkaktimi i rezikur të përgjithshëm, dëmtimi i sendeve të huaja, dëmtimi, shkatrimi i përmendoreve apo objekteve të mbrojtura.

Senaca kryesore është mbajtur para kolegjit të përzier treanëtarësh të Gjykatës së Qarkut në Prizren/Prizren, të cilin e ka kryesuar gjyqëtari ndërkombëtarë, anëtarë të kolegjit kanë qenë gjyqëtarët porotë.

Të akuzuarit kanë pranuar kryerjen e disave nga veprat penale për të cilat u janë shqiptuar denimet: Jeton Zogaj është dënuar me denim me burg në kohëzgjatje prej 2 vitesh; Artan Bytyqi me dënim me burg në kohëzgjatje prej dy vitesh(i cili nuk do të ekzekutohet nëse ai në periudhën prej pesë vitesh nuk kryen ndonjë vepër penale); Gazmend Xhoxhaj me denim me burg në kohëzgjatje prej 22 muaj (i cili nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej 5 vitesh nuk kryen ndonjë vepër penale)

Konkludim:

Gjykimet e theksuara paraqesin gjykime më të rëndësishme ndaj kryesve të veprave penale gjatë trazirave të marsit.

Sipas të dhënave të OSBE-s për monitorim, e cila në mënyrë permanente ka përcjellur gjykimet lidhur me trazirat e marsit, kishte shumë pak aktakuza duke marrë parasysh numërin e madh të pjesëmarrësve në trazira i dhe në raport me pasojat.

Gjithashtu konsiderojmë se denimet e shqiptuara janë shumë të vogla, përveç denimeve të theksuara më lartë, me ç'rast bëhet falë për rastet më serioze, të cilat kryesisht kanë lëvizur rreth minimumi ligjor, pa marrë parasysh në vështirësitë që gjykatat ballafaqohen në punë (problemet me grumbullimet e dëshmimeve, mungesa e dëshmimeve, vështirësitë e sigurimit të dëshmimeve për shkak të numrit të madh të incidenteve për një periudhë shumë të shkurtër, hezitimi i dëshmitarëve për të dëshmuar, frika e të dëmtuarve për të vazhduar jetën në Kosovë, shpërngulja e të dëmtuarve pas këtyre ngjarjeve, si dhe përfundimi i angazhimit të policisë ndërkombëtare në misionin e UNMIK-ut.

Rezime

Në respektimi e të drejtave të pakicave në Kosovë gjatë vitit 2005 është bërë një përparim i dukshëm, kë krahasim me vitet e kaluara, mirëpo kjo është ende larg nga niveli që dëshirohet. Serbët e Kosovës ende jetojnë me frikë se siguria e tyre në çdo moment mund të rrezikohet. Në këtë kanë ndikuar një varg incidentesh, kryesisht etnikisht të motivuara. Të njëjtën frikë e kanë edhe romët e Kosovës, të cilët shpesh herë ishin cak i shqiptarëve vendës. Sa u përket komuniteteve pakicë situata dukshëm ndryshon. Turqit, boshnjakët dhe ashkalinjtë e Kosovës dhe të tjerët nuk kanë probleme të tilla, sa i përket sigurisë, lëvizjes së lirë dhe të drejtave të tjera. Problemi më i madh tek pjesëtarët e këtyre komuniteteve pakicë është e drejta në punësim. Përveç në institucionet e sistemit,

në të cilat është punësimi proporcional, në të gjitha ndërmarrjet tjera publike pjesëtarët e komuniteteve pakice, me rastin e punësimit janë të diskriminuar. Si shembull i keq për këtë mund të përmendet PTK(Post – Telekomunikacioni), KEK- Korporata Energjetike e Kosovës), si dhe të gjitha ndërmarrjet komunale nëpër komuna.

Liria e lëvizjes

Edhe pse siguria në Kosovë është përmirësuar në vitin 2005, pjesëtarët e pakicave etnike, sidomos serbët dhe romët ende nuk lëvizin lirisht nëpër Kosovë. Situata më e vështirë është në rajonin e Pejës, derisa në rajonin e Prizrenit ka lëvizje pozitive. Në këtë rajon situata është kthyer në gjendjen para ngjarjeve të marsit. Serbët në Prizren lëvizin lirisht sikurse edhe para ngjarjeve të marsit.

Kthimi i të zhvendosurve

Procesi i kthimit të zhvendosurve gjatë vitit 2005 ishte më dinamik, se sa në periudhën paraprake. Për ndryshim nga vitet paraprake ka shembuj të kthimit të serbëve në mjediset urbane, siç është rasti me kthimin në Klinë. Në shtimin e numrit të njerëzve që shprehën dëshirën për tu kthyer në shtëpitë e tyre ka ndikuar formimi i Ministrisë për komunitete dhe kthim, në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Pavarsisht nga fakti se në shumë mjedise në Kosovë po zhvillohet kthimi pa ndonjë problem, një numër i madh i të zhvendosurve edhe më tutje jetonë në kushte të vështira nëpër vendbanime kolektive dhe presin krijimin e kushteve për kthimin e tyre.

Qasje e barabartë në institucione

Fondi për të Drejtën Humanitare në bazë të hulumtimeve të veta është i mendimit se pjesëtarët e grupeve të vogla, sidomos, serbët, romët, hashkalinjtë dhe egjiptasit janë jo mjaftë të përfaqësuar në shërbimet civile edhe pse ka përparim në krahasim me periudhën paraprake, edhe këto ndryshime janë larg nivelit të dëshirueshëm. Edhe ato ligje që i ka miratuar Qeveria e Kosovës lidhur me qasjen në shërbime dhe institucione publike, përdorimin e gjuhëve po hasin në vështirësi në përjashtim të disa komunave.

Dhuna/incidentet me motive etnike dhe racore

Numri i incidenteve, përkatësisht sulmeve mbi pjesëtarët e komuniteteve pakicë gjatë vitit 2005 është më i vogël në krahasim me periudhën paraprake.⁹

⁹ Sipas të dhënave të UNMIK-ur në Kosovë, nga prilli i vitit 2005 krimi ka rënë në masë të konsiderueshme. Nga qershori deri në dhjetor të vitit 1999 kishte 500 vrasje, vitin 2000, 204 vrasje, në vitin 2001 107 vrasje, në vitin 2002, 70 vrasje dhe në vitin 2003 pati 72 vrasje. Nga janari deri në tetor 2004 ishin 80 vrasje. Nga këto 80 viktima 11 janë serbë. Në burxhet kosovare denimin e vuajnë 1199 persona.

Megjithatë, këtë vitë është vërejtur një dukuri e veçantë, e kjo është sulmi mbi pjesëtarët e SHPK, nga radhët e komunitetit serb. Janë evidentuar dy raste të tilla në afërsi të komunës Shtërpce, fatkeqësisht deri më tash asnjë nga ato ngjarje nuk është ndriçuar. Kjo ka ndikuar negativisht jo vetëm tek pjesëtarët e SHPK, nga radha e komuniteteve pakicë, por në përgjithësi tek të gjithë njerëzit që u përkasin komuniteteve pakicë.

Gjykimet lidhur me ngjarjet e marsit

Gjykimet e theksuara në këtë raport paraqesin gjykime më të rëndësishme të organizuara ndaj kryesve të veprave penale në trazirat e marsit.

Fondi për të Drejtën Humanitare konsideron se dënimet e shqiptuara janë të buta, përjashtimisht të disave të cekura më lartë, që kanë të bëjnë me rastet më serioze të shkeljes së ligjit. Ato kryesisht lëvizin brenda minimumit ligjorë, gjë që nuk mund të arsyetohet, pavarësisht nga vështirësitë me të cilat janë ballafaquar gjykatat gjatë punës.

Janë vërejtur problemet si vijon: vështirësi rreth mbledhjes së dëshmive, mungesës së dëshmive, vështirësi në mbledhjen e dëshmive për shkak të numrit të madh të incidenteve në periudhë shumë të shkurtër, vështirësitë me dëshmitarët dmth. hezitimi i tyre për të dëshmuar, ekzistimi i frikës tek të dëmtuarit, të cilët janë të vendosur të jetojnë në Kosovë, zhvendosja e të dëmtuarve pas këtyre ngjarjeve etj.

Rekomandime

Për të pasur qasje më serioze për zgjidhjen e problemeve të komuniteteve pakicë, Fondi për të Drejtën humanitare rekomandon si në vijim:

- Ligjet që i ka miratuar Qeveria e Kosovës duhet të zbatohen në tërësi, në të gjitha nivelet, si në nivel të Kosovës ashtu edhe në nivelin lokal.
- Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës duhet të shfrytëzojnë sa më mirë resurset njerëzore, pavarësisht nga përkatësia e tyre nacionale, etnike, fetare, racore apo gjinore.
- Të shtohet prania e organeve të sigurisë – TMK, SHPK, UNMIK, KFOR – në rajonet me popullsi të përzier, të shtohet siguria për të gjithë qytetarët e Kosovës, të ndriçohen krimet në mënyrë që të forcohet besimi i qytetarëve në këto institucione.
- Pjesëmarrje më e madhe dhe promovimi i të drejtave njerëzore, për barazi për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe gjyrimi i akteve kriminale.

- Të ndërtohet strategjia e paqës, tolerancës dhe shkëputja nga e kaluara rrëqethëse, për të zhvendosurit, etj.
- Zyrtarët e Qeverisë, në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar duhet të ndërtojnë strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe punësimit, sidomos të shtresave të reja të popullsisë Kosovare.